Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*
*Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije*
*Ministry of Education Science &Technology*

# Korniza e Kurrikulës

## e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*
*Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije*
*Ministry of Education Science &Technology*

# Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës

Prishtinë, gusht 2011

## MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

**Këshilli redaktues:**

Nehat Mustafa

Drita Kadriu

Ramush Lekaj

**Lektori:**

Sulejman Dermaku

**Dizajni:**

www.xhad.net

**Shtypshkronja:**

Grafika Rezniqi

Ky publikim është zhvilluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë,
me mbështetjen e UNICEF Zyra në Kosovë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Nr. 262 /01 B
Dt. 29. 08. 2011

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

**V E N D I M**

1. Miratohet dokumenti *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.*
2. Shfuqizohen dokumentet e llojit të tillë të hartuara apo edhe të miratuara më parë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**A r s y e t i m**

Duke pasur parasysh dispozitat e lartcekura dhe kërkesën nr.261/ 01-B , të dt. 29.08.2011, dokumenti *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës* është i kompletuar dhe i zbatueshëm në sistemin e arsimit të Kosovës.

Dokumenti synon ndryshimin e vazhdueshëm dhe progresiv të arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës.

Korniza e Kurrikulës vendos themelet për ngritjen e cilësisë dhe të barazisë në shërbimet arsimore për të gjithë nxënësit/et dhe ndërlidhjen e sistemit të arsimit të Kosovës me reformat aktuale arsimore ndërmjet sistemeve më të zhvilluara.

Ky dokument do të shërbejë si bazë e mirë për hartimin dhe zbatimin e një vargu të dokumenteve tjera për zhvillimin e arsimit parauniversitar.

Dokumenti mundëson zbatimin me sukses të ndryshimeve progresive të identifikuara po nga ky dokument dhe nga dokumentet përcjellëse që synojnë sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Sekretarit të përgjithshëm;
3. Departamentit të ZHAP;
4. Departamentit ligjor dhe
5. Arkivit .

Prof. dr. Ramë Buja, minister

# Fjala e Ministrit

**Nxënës, mësimdhënës, përfaqësues të arsimit,
Prindër dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,**

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Republikës së Kosovës para jush paraqet Kornizën e Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar të Kosovës.

Ky dokument ka rol qenësor në promovimin e vizionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për mësim gjatë gjithë jetës dhe ka për bazë vizionin e MASHT-it për ndërtimin e një shteti të dijes.

Hartimi i një Kurrikule është gjithherë sfidues për shtetin dhe sistemin arsimor, sepse paraqet një katalizator të qëllimeve, të fuqisë dhe të vlerave më të mira për vendin. Në këtë drejtim, hartimi i Kornizës së Kurrikulës demonstron përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të rigjenerojë një sistem të arsimit, i cili është valid në nivel të vendit dhe i respektuar në nivel ndërkombëtar.

Synimi është që zhvillimi i kompetencave për jetë dhe punë të udhëheqë procesin e zhvillimit të sistemit të Kurrikulës dhe përvojave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Korniza e Kurrikulës e vënë para jush reflekton çështjet dhe shqetësimet e ngritura gjatë debateve publike, të organizuara me ju: nxënës, mësimdhënës, drejtorë të shkollave, përfaqësues të autoriteteve komunale, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të arsimit dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Falënderimi im ju drejtohet të gjithë Juve!

Kalimi nga Kurrikula e bazuar në përmbajtje në një Kurrikulë që bazohet në kompetenca, synon sigurimin e një autonomie të shtuar të shkollës, ngritjen e llogaridhënies në nivel shkolle drejt mobilizimit të potencialit të rinisë kosovare që me sukses të konkurrojë në tregun e punës, si në vend ashtu dhe jashtë vendit.

Zgjidhjet e propozuara me këtë dokument kanë parasysh nevojat e menjëhershme për përmirësime të sistemit arsimor parauniversitar në Kosovë dhe trendët aktualë arsimorë të vendeve të zhvilluara, në mënyrë që nxënësit tanë të jenë konkurrentë me bashkëmoshatarët e tyre në Evropë e më gjerë.

MASHT-i çmon potencialin e rinisë në Republikën e Kosovës, vlerëson lart përkushtimin e mësimdhënësve dhe mbetet i përkushtuar për të siguruar mundësitë që ky Dokument të jetësohet në të gjitha shkollat tona.

Sinqerisht,
**Prof. Dr. Ramë Buja, Ministër**

# PËRMBAJTJA:


Vendimi....3

Fjala e Ministrit....5

Shkurtesat....8

Hyrje....9

PJESA I
KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS
ROLI, FUNKSIONI, STRUKTURA

1 Roli dhe funksioni i Kornizës së Kurrikulës....13

1.2 Synimi....14

1.3 Qëllimet e arsimit parauniversitar....15

2 Kompetencat kryesore të të nxënit....16

3 Parimet e Kornizës së Kurrikulës....23

4 Korniza e Kurrikulës nëpër nivelet e arsimit: shkallët e Kurrikulës dhe roli i tyre në organizimin e punës edukativo-arsimore në shkollë....27

4.1 Struktura e sistemit të arsimit parauniversitar: veçoritë e niveleve të arsimit dhe ndikimi i tyre në Kurrikulë....28

4.2 Shkallët e Kurrikulës dhe roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e punës edukativo-arsimore në shkollë....31

5 Fushat, lëndët dhe modulet mësimore në nivele dhe shkallë të Kurrikulës....35

5.1 Fushat e Kurrikulës dhe lëndët mësimore....35

5.2 Fondi i orëve....42

5.3 Autonomia e shkollës për zhvillimin e pjesës zgjedhore të Kurrikulës....45

6 Dokumentet e Kurrikulës: çka pritet nga shkollat dhe nga mësimdhënësit?....45

6.1 Hierarkia e dokumenteve të Kurrikulës së Kosovës....46

6.2 Kurrikula Bërthamë....46

6.3 Planet dhe programet sipas lëndëve....48

7 Sistemi i vlerësimit të nxënësve....49

7.1 Vlerësimi i brendshëm....49

7.2 Vlerësimi i jashtëm....52

# PJESA II
# ZBATIMI I KORNIZËS SË KURRIKULËS

1 Roli i shkollës: sigurimi i një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e kompetencave ....56

2 Hartimi i materialeve të reja për mësimdhënie dhe nxënie në mbështetje të zhvillimit të kompetencave ....58

3 Zbatimi i Kornizës së Kurrikulës për arsimin parauniversitar ....60

3.1 Faza përgatitore për zbatimin e Kornizës së Kurrikulës ....61

3.2 Aplikimi gradual i pakos së plotë të Kurrikulës ....64

FJALORTHI ....65

Bibliografia ....78

Në hartimin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës morën pjesë ....84

# Shkurtesat

| | |
|---|---|
| **KK** | Korniza e Kurrikulës |
| **APGj** | Arsim për të gjithë |
| **ADNj** | Arsimi për të Drejtat e Njeriut |
| **AZHQ** | Arsimi për Zhvillim të Qëndrueshëm |
| **IBE** | Zyra Ndërkombëtare për Arsim e UNESKO-s |
| **SNKA** | Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESKO - ISCED) |
| **ShK** | Shkallët e Kurrikulës |
| **KSHKK** | Këshilli Shtetëror i Kurrikulave i Kosovës |
| **QMZh** | Qëllimet e Mijëvjeçarit për Zhvillim |
| **MASHT** | Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë |
| **OJQ** | Organizata joqeveritare |
| **OECD** | Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik |
| **RN** | Rezultatet e të Nxënit |
| **REN** | Rezultatet Esenciale të të Nxënit |
| **ShK** | Shkalla e Kurrikulës |
| **PISA** | Programi i OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve |
| **AAM** | Arsimi dhe Aftësimi i Mësimdhënësve |
| **ET** | Ekipi Teknik |
| **AAP** | Arsimimi dhe Aftësimi Profesional |
| **AKK** | Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve |
| **UNESCO** | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë |
| **UNICEF** | Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara |
| **BB** | Banka Botërore |
| **ZNKE** | Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian |

# Hyrje

## Nevoja për Kurrikulë

### *KOSOVA SHTET I DIJES*

Sektori i arsimit në Kosovë karakterizohet nga përpjekje intensive reformuese në të gjithë nënsektorët, që kanë për qëllim të trajtojnë sfidat kryesore të rritjes së pjesëmarrjes dhe përmirësimit të cilësisë së arsimit në kushte të mjeteve të kufizuara në dispozicion.

Gjatë dekadës së fundit janë miratuar akte të shumta ligjore e nënligjore, janë ndërtuar shumë shkolla dhe janë themeluar institucione të shumta të reja. Ka pasur përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e kurrikulave dhe hartimin e sigurimin e teksteve të reja shkollore.

Me gjithë arritjet në reformat arsimore, mbeten edhe shumë sfida që duhen përballur. Për zbatimin e politikave të reja për arsimin e detyruar parafillor dhe arsimin e mesëm të lartë duhet kërkuar numër i shtuar i mësimdhënësve të aftësuar. Po ashtu, mjete mësimore më cilësore dhe më shumë klasa për të plotësuar kërkesat për regjistrim në shkollat e mesme, duke zbritur mesataren e tanishme prej 32.3 nxënësve për një klasë në shkollat e mesme të larta (të vendosura kryesisht në zonat urbane).

Për shkak të lëvizjeve demografike fshat – qytet, sidomos në dhjetëvjetëshin e fundit, statistikat tregojnë se shkollat fillore dhe të mesmet të ulëta, në zonat rurale dhe urbane, nuk janë të popullit njëtrajtësisht (shkollat urbane janë të mbingarkuara, derisa shkollat rurale janë gjysmë të zbrazëta). Shumë shkolla në Kosovë punojnë ende në 2 dhe 3 ndërresa, që nënkupton klasa të mbingarkuara dhe numër të zvogëluar të orëve mësimore e të qëndrimit në shkollë.

Përkujdesja dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme vazhdon të ketë mungesë të madhe të mësimdhënësve/edukatorëve të kualifikuar e të aftësuar për arsimin parashkollor. Cilësia e përkujdesjes dhe e edukimit është kufizuar për shkak të numrit të vogël të mësimdhënësve të kualifikuar.

Rritja e përfshirjes në shkollim, përmirësimi i shkallës së mbarimit të shkollimit dhe të drejtat e barabarta gjinore në shkollim do të varen nga përmirësimi i cilësisë së arsimit, nga sigurimi i shpërndarjes së barabartë të resurseve dhe nga eliminimi i shkaqeve për ndërprerjen e shkollimit nga ana e fëmijëve që vijnë nga familje të varfra dhe grupe të margjinalizuara të shoqërisë.

**Sfidat e tjera me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare:**

- **Nevoja për ndërtimin e një shoqërie të dijes:** Për shkak të zhvillimeve të shpejta teknologjike dhe shoqërore, mundësia për të zgjeruar dijen është e pakufizuar. Sot, dija konsiderohet kapitali më i rëndësishëm për gjenerim të ideve të reja dhe të mirëqenies. Për shkak të qasjes së pakufizuar informatave dhe nevojës për t'u ballafaquar me kontekste dhe sfida të reja të një shoqërie të dijes, shkollat duhet t'u

ndihmojnë të rinjve që, krahas kompetencave të përgjithshme për jetë dhe punë, të zhvillojnë edhe kompetencat adekuate për qasje dhe përpunim të informacionit në mënyrë të pavarur.

- **Integrimi në epokën digjitale**: Shoqëria e dijes gjeneron dhe zhvillohet gradualisht në një epokë të re digjitale/elektronike dhe mjaft sfiduese. Për t'u integruar me sukses në një ekonomi digjitale/elektronike, nxënësve u nevojiten kompetenca digjitale. Prandaj, krahas njohurive themelore të alfabetizimit, shkrim-leximit dhe numërimit, sistemi aktual i arsimit duhet të nënkuptojë e të përfillë vetëdijesimin dhe alfabetizimin digjital, në mënyrë që të arrijë shkallën e alfabetizimit të plotë funksional. Megjithatë, vetëm njohuritë dhe shkathtësitë digjitale nuk mjaftojnë për të krijuar personalitete komplekse për epokën digjitale, sepse forcën kryesore të botës digjitale e përbëjnë njerëzit dhe vlerat themelore që ata promovojnë.
- **Rritja e ndërvarësisë dhe e lëvizshmërisë:** Në saje të ndikimit të aspekteve të ndryshme të globalizimit (për shembull, në sferën e komunikimit, të kapitalit, të udhëtimit, të arsimit, të kulturës, të migrimit, të stilit të jetesës), të gjitha vendet e botës sot janë gjithnjë e më të ndërvarura. Ndërvarësia e botës së sotme, si dhe zhvillimet e reja në tregun e punës kërkojnë sigurimin e parakushteve për lëvizje dhe konkurrencë të suksesshme të të rinjve në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Kjo ka ndikim edhe në identitetin individual dhe kolektiv dhe në perceptimin: "universale" apo "ndërkombëtare", krahasuar me atë që konsiderohet tradicionale, lokale, shtetërore dhe "kombëtare". Të rinjtë, më shumë se kurdoherë më parë, duhet të jenë në gjendje t'u përshtaten ndryshimeve të shpejta dhe të paparashikuara, si, për shembull, kriza ekonomike dhe financiare, përhapja e sëmundjeve ngjitëse dhe konfliktet e vazhdueshme.
- **Të mësuarit për të jetuar së bashku:** Paraqet një ndër sfidat kryesore në një botë të hapur dhe të ndërvarur, përfshirë menaxhimin konstruktiv të dallimeve, zgjidhjen paqësore të konflikteve, tolerancën, respektin për vetveten, respektin për të tjerët, mirëkuptimin ndërkulturor si dhe komunikimin efektiv. Për Kosovën, si shoqëri shumetnike, "të mësuarit për të jetuar së bashku" është një sfidë dhe prioritet, kur merret parasysh procesi i integrimit në Bashkimin Evropian, ku Kosova synon të marrë pjesë aktive. Kjo përfshin promovimin e vlerave dhe të praktikave që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen, vizionin ndërkulturor, qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut në kontekstin e jetës publike, profesionale dhe private.
- **Zhvillimi i qëndrueshëm:** Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, ku cilësia e jetës në Tokë, për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, është e kërcënuar, nxënësit duhet të pajisen me dije, me shkathtësi dhe me qëndrime për t'u kujdesur me përgjegjësi për ambientin e krijuar nga natyra dhe nga dora e njeriut, në mënyrë që t'u shmangen shpërdorimit të burimeve dhe praktikave të tjera të papërgjegjshme. Kjo kërkon që të rinjtë të vetëdijesohen jo vetëm për parimet dhe përvojat e kohezionit shoqëror dhe gjithëpërfshirjes, por edhe se si të luftohen varfëria, margjinalizimi, diskriminimi dhe padrejtësia në mënyrë sa më efektive.

Përballja e sfidave të lartpërmendura kërkon një reformë të plotë të Kurrikulës për shkollimin parauniversitar dhe për sigurimin e kushteve dhe mbështetjen e nevojshme për zbatimin e plotë të saj.

Hapi i parë në reformimin e arsimit parauniversitar është hartimi i Kornizës së Kurrikulës, që vendos themelet për ngritjen e cilësisë dhe barazisë në shërbimet arsimore për të gjithë nxënësit dhe ndërlidhjen e sistemit të arsimit me synimet dhe reformat aktuale arsimore ndër sistemet më të zhvilluara.

# 1

## KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS

ROLI, FUNKSIONI, STRUKTURA

# 1. Roli dhe funksioni i Kornizës së Kurrikulës

Korniza e Kurrikulës përbëhet nga një tërësi e dokumenteve dhe masave të përcaktuara për zbatimin e saj. Këto dokumente ndahen në dy komponentë kryesorë:

- ❑ Komponentin konceptual, që është vetë Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe
- ❑ Komponentin operativ - që e përbëjnë dokumentet shoqëruese, të cilat mundësojnë zbatimin e KKK-së në nivel të sistemit arsimor duke përcaktuar qartë pritshmërinë nga nxënësit, nga mësimdhënësit dhe nga shkollat. Për rolin dhe funksionin e këtyre dokumenteve do të flitet në kapitullin VI - Komponenti operativ i dokumentit.

Dokumeni i Kornizës së Kurrikulës rregullon tërë sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës. Ai përcakton:

- Qëllimet e arsimit parauniversitar, realizimi i të cilave obligon të gjitha institucionet arsimore dhe aktorët e tjerë që janë pjesëmarrës në procesin edukativo-arsimor të Republikës së Kosovës.
- Kompetencat kryesore, të cilat duhet të përvetësohen nga të gjithë nxënësit deri në përfundim të shkollës së mesme të lartë.
- Parimet kryesore për të udhëhequr procesin e hartimit dhe të zbatimit të Kurrikulës në Republikën e Kosovës.
- Nivelet formale dhe profilet e arsimit nga perspektiva e reformës së Kurrikulës.
- Fushat e Kurrikulës dhe lëndët mësimore, fushëveprimin e tyre nëpër shkallët e Kurrikulës dhe minimumin e kohës së ndarë për secilën fushë gjatë një shkalle të Kurrikulës.
- Hierarkinë e dokumenteve të Kurrikulës, përfshirë funksionin, përmbajtjen dhe çështjet qenësore që duhet të trajtohen në kuadër të dokumenteve të ndryshme që e përbëjnë tërësinë e Kurrikulës shtetërore.
- Llojet, kohën dhe mënyrën e vlerësimit në nivel klase, shkolle, komune dhe shteti në përputhje me sistemin e rezultateve të të nxënit, të përcaktuara me Kurrikulën shtetërore.
- Implikimet e Kurrikulës shtetërore për hartimin e materialeve të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Rolin e shkollës në funksion të zbatimit të reformës së Kurrikulës.
- Planin e zbatimit të Kornizës së Kurrikulës, përfshirë të gjitha aktivitetet e domosdoshme dhe afatet kohore për realizimin e fazës përgatitore dhe fazës së zbatimit.

## 1.2. Synimi

Korniza e Kurrikulës synon që qytetarët e Kosovës të ballafaqohen me sfidat e shekullit XXI dhe të gjenerojnë dije të reja konkurruese në mënyrë aktive për tregun global të punës.

## 1.3. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi në Kosovë ka për qëllim zhvillimin e dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Kjo u mundëson të rinjve të jenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, të përballin në mënyrë konstruktive dallimet dhe sfidat si dhe të respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve.

Të rinjve, arsimi në Kosovë do t'u krijojë kushte për zhvillim të pavarur, në mënyrë që të përmbushin jetën e tyre personale dhe të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare.

**Në këtë kontekst, qëllimet e arsimit janë:**

- ❑ kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore
- ❑ promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare
- ❑ zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit
- ❑ aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore
- ❑ zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë
- ❑ aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

Arsimi do t'u mundësojë nxënësve që të kuptojnë, të respektojnë dhe të kultivojnë traditat kombëtare dhe të komunitetit ku jetojnë, të vlerësojnë traditat e familjes, të kultivojnë dhe të kontribuojnë në pasurimin e trashëgimisë së tyre kulturore, të rajonit ku jetojnë dhe më gjerë.

Nxënësit do të aftësohen që të shfrytëzojnë në mënyrë kreative dijen dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe kontekste të reja; të angazhohen në mënyrë individuale dhe në bashkëpunim me të tjerët në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe të ushtrojnë shkathtësitë për mendim të pavarur dhe kritik.

Nxënësit do të përkrahen që të zhvillojnë përgjegjësinë për veten, për të tjerët dhe për mjedisin, në kontekst të vetëdijesimit për pasojat e veprimeve personale, si dhe vetëdijesimit për rëndësinë dhe përgjegjësinë për ndërmarrjen e iniciativave.

Nxënësit do të përkrahen që të zhvillojnë vetëbesimin dhe motivimin pozitiv, si dhe të shfrytëzojnë të drejtat e tyre. Ata do të përkrahen që të kultivojnë kërshërinë e tyre si dhe qëndrimin pozitiv ndaj së ndryshmes, në kuptim të ideve, fenomeneve, personave, kulturave etj.

Arsimi do t'u mundësojë nxënësve të kontribuojnë me tërë potencialin e tyre në ndërtimin dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare, duke zhvilluar njëkohësisht pavarësinë e tyre individuale dhe aftësinë për të ndërtuar jetën që ata i përmbush personalisht.

Qëllimet e përgjithshme të arsimit janë të integruara në rezultatet e përcaktuara të të nxënit, në përmbajtjet mësimore dhe duhet të jenë në kulturën e përditshme të shkollës. Realizimi i tyre obligon të gjitha institucionet arsimore dhe aktorët e tjerë që janë pjesëmarrës në procesin edukativo-arsimor të Republikës së Kosovës.

# 2. Kompetencat kryesore të të nxënit

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura.

Kompetencat e parapara me Kornizën e Kurrikulës rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar.

**Në përputhje me qëllimet e arsimit kosovar, kompetencat kryesore të parapara për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës:**

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet se si kompetencat kryesore shpalosen më tutje në nënkompetenca të tjera më operacionale dhe se si ato ndërlidhen mes vete, për të dhënë produktin dhe rezultatin përfundimtar në fund të shkollimit parauniversitar.

| Kompetencat kryesore | Rezultati për-fundimtar |
|---|---|
| **1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**<br>o Komunikimi nëpërmjet gjuhës amtare<br>o Komunikimi nëpërmjet gjuhëve të huaja<br>o Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike<br>o Komunikimi nëpërmjet teknologjisë informative<br>o Angazhimi dhe kontributi për dialog produktiv<br>o Respektimi i rregullave të komunikimit<br>o Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive<br>o Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim<br>o Inicimi i veprimeve konstruktive | **Komunikues efektiv** |
| **2. Kompetenca e të menduarit**<br>o Kompetencat matematikore dhe kompetencat themelore në shkencë dhe në teknologji<br>o Kompetencat digjitale<br>o Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit<br>o Zhvillimi i mendimit abstrakt<br>o Marrja e vendimeve të bazuara në informacione të verifikuara<br>o Lidhja e vendimeve me pasojat<br>o Vlerësimi dhe vetëvlerësimi<br>o Zgjidhja e problemeve | **Mendimtar kreativ** |
| **3. Kompetenca e të mësuarit**<br>o Mësimi për të mësuar<br>o Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit<br>o Zotërimi i mirëfilltë i leximit, i shkrimit, i matematikës, i shkencës, i teknologjisë së informacionit e komunikimeve<br>o Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme<br>o Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive | **Nxënës i suksesshëm** |

| | |
|---|---|
| **4. Kompetenca që ka të bëjë me punën, jetën dhe mjedisin**<br>o Prezantim i vetvetes në paraqitjen më të mirë, duke theksuar zotësitë që posedon<br>o Punë e pavarur dhe si pjesë e ekipeve punuese<br>o Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore<br>o Dëshmim i shkathtësive ndërmarrëse, i njohurive për planifikim të punës, i shfrytëzimit racional të kohës<br>o Zotërim i aftësive për menaxhim të konflikteve dhe vlerësim të rreziqeve<br>o Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme<br>o Angazhim në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit | **Kontribuues produktiv** |
| **5. Kompetenca personale**<br>o Dëshmim i të njohurit të vetes dhe të tjerëve<br>o Dëshmim i vetëbesimit<br>o Menaxhim i emocioneve dhe i stresit<br>o Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët<br>o Dëshmim i aftësive për të bërë jetë të shëndoshë<br>o Bërja e zgjedhjeve të përgjegjshme për shëndetin personal | **Individ i shëndoshë** |
| **6. Kompetenca qytetare**<br>o Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore<br>o Mirëkuptim dhe respektim i dallimeve ndërmjet njerëzve<br>o Tolerancë dhe respekt për të tjerët<br>o Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare<br>o Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin | **Qytetar i përgjegjshëm** |

Kompetencat e komunikimit dhe të të shprehurit, kompetencat e të menduarit dhe kompetencat për të mësuar janë të natyrës instrumentale: ato janë bazë për kompetencat e tjera, që janë më tepër të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën private, publike dhe profesionale.

Kompetencat e komunikimit dhe të të shprehurit (“Komunikues efektiv”)

Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t’i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike.

Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

| Kompetencat e komunikimit dhe të të shprehurit në formë të rezultateve të të nxënit |
|---|
| Me rastin e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:<br>- të komunikojnë dhe të shprehen nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave dhe kodeve;<br>- të flasin, të dëgjojnë, të lexojnë e të shkruajnë dhe të shprehen në gjuhën amtare dhe në (së paku) një gjuhë tjetër të huaj;<br>- të angazhohen dhe të kontribuojnë në dialog të respektueshëm dhe produktiv;<br>- të japin dhe të pranojnë informata kthyese në mënyrë konstruktive dhe kreative;<br>- të respektojnë rregullat e përgjithshme të komunikimit/ndërveprimit dhe njëkohësisht të jenë kreativë;<br>- të përdorin programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënies dhe kryerjes së detyrave shkollore;<br>- të përdorin TIK-un dhe mediet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme si mjete të rëndësishme të informimit, të komunikimit dhe të ndërveprimit në epokën digjitale. |

### Kompetencat e të menduarit ("Mendimtar kritik")

Qasja dhe përpunimi i njohurisë në mënyrë të pavarur, efektive dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, por edhe për të marrë vendime dhe për të zgjidhur probleme me vetëdije të plotë për ndikimin dhe pasojat e vendimit dhe të veprimit të caktuar. Duke mbajtur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë esenciale për shekullin XXI. Megjithatë, përveç aftësisë për të identifikuar dhe për t'iu qasur informatës/burimit të njohurisë së caktuar, nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë edhe kapacitete për t'iu qasur njohurive në mënyrë kritike, kreative dhe ndërvepruese.

| Kompetencat e të menduarit, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënit |
|---|
| Me rastin e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:<br>- të identifikojnë, të lokalizojnë dhe t'i qasen informatës së duhur;<br>- të përpunojnë në mënyrë kritike informatën (të analizojnë, të sintetizojnë, të organizojnë, të shfrytëzojnë dhe të zbatojnë);<br>- të zbatojnë njohurinë në kontekst të zgjidhjes së problemit nëpërmjet veprimeve të përshtatshme;<br>- të gjykojnë drejt, në bazë të analizës dhe sintezës paraprake të fakteve dhe situatave;<br>- të ilustrojnë me mjete konkrete të menduarit abstrakt;<br>- të vlerësojnë mundësitë e ndryshme dhe të marrin vendime të drejta;<br>- të lidhin vendimet e tyre me pasojat në mënyrë të përgjegjshme;<br>- të vlerësojnë cilësinë e informatave, rëndësinë e tyre dhe vlerën kundrejt qëllimit për të cilin nevojiten informatat e caktuara;<br>- të vetëvlerësojnë paraqitjen vetjake krahas rezultateve të pritura;<br>- të menaxhojnë informatat në mënyrë kritike, kreative dhe të përgjegjshme;<br>- të bëjnë zgjidhjen e problemeve në nivelin e caktuar të vështirësisë. |

### Kompetencat e të mësuarit tërëjetësor ("Nxënës i suksesshëm")

Në trendët aktualë të zhvillimit në shoqëri, në shkencë, në teknologji e në ekonomi nuk mund të pretendohet që të gjitha njohuritë, shkathtësitë e aftësitë e nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit. Prandaj, nga shkolla pritet që të japë një bazë të mirë të arsimimit dhe të përgatisë nxënësit për një proces të mësimit tërëjetësor.

Për një "nxënës të suksesshëm" shkolla angazhohet të kultivojë vazhdimisht kërshërinë e natyrshme të fëmijëve/të rinjve dhe interesimin për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencat për të mësuar. Ajo po ashtu duhet të vetëdijesohet për stilet dhe strategjitë efektive mësimore.

| **Kompetencat e të mësuarit tërëjetësor, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënit** |
|---|
| Me rastin e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:<br>- të kuptojnë dhe të çmojnë nevojën për mësim gjatë tërë jetës;<br>- të demonstrojnë shkathtësi funksionale në shkrim-lexim, në matematikë, në shkenca, në TIK dhe në situata të përditshme;<br>- të njohin përparësitë dhe dobësitë e tyre dhe stilet e strategjitë e preferuara të të nxënit;<br>- të mbështesin dijet e reja mbi përvojat paraprake dhe t'i shfrytëzojnë ato;<br>- të vendosin dhe të prioritetizojnë qëllimet e tyre të të nxënit;<br>- të ndjekin përparimin e vet dhe të bëjnë intervenimet e domosdoshme për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme;<br>- të kultivojnë motivimin e tyre për mësim;<br>- të mësojnë duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike;<br>- të kërkojnë dhe të shfrytëzojnë këshillat, informatat dhe përkrahjen kur është e nevojshme;<br>- të ndërmarrin iniciativa, të vlerësojnë rreziqet dhe të përballin vështirësitë në të nxënë;<br>- të menaxhojnë burimet që i kanë në dispozicion, kohën, njerëzit dhe mjedisin e tyre në mënyrë produktive dhe të përgjegjshme;<br>- të bashkëpunojnë me të tjerët, të menaxhojnë konfliktet;<br>- të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme;<br>- të vlerësojnë në mënyrë kritike punën e tyre duke iu referuar qëllimeve fillestare. |

### Kompetencat për jetë, për punë dhe për mjedis ("Kontribuues produktiv")

Shkollat duhet të përgatisin nxënësit për të jetuar dhe për të punuar në një botë shumë të ndërvarur dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI kërkon kompetenca për të përballur rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitet për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për përparim personal dhe përparim të shoqërisë e mjedisit.

Për të zhvilluar këto kompetenca, shkolla përkrah nxënësit që të kuptojnë në mënyrë të plotë ndërvarësinë ndërmjet fenomeneve ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë lokale dhe globale. Ajo kultivon te nxënësit orientimin drejt së ardhmes, ndërmarrësinë

dhe motivimin e qëndrueshëm për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, shkolla angazhohet që t'i ballafaqojë nxënësit me preokupime ekologjike, duke i vetëdijesuar për rolin e secilit në mbrojtjen dhe kultivimin e mjedisit.

| **Kompetencat për jetë, për punë dhe për mjedis, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënit** |
|---|
| Me rastin e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:<br>- të prezantojnë veten me shkrim dhe me gojë, duke përpiluar CV (biografinë) në formate të kërkuara;<br>- të kuptojnë kompetencat e nevojshme për situatat e ndryshme jetësore dhe shtigjet e ndryshme të karrierës;<br>- të hulumtojnë dhe t'u qasen mundësive relevante në dispozicion për arsimim dhe përgatitje profesionale si dhe për këshillim;<br>- të manifestojnë shkathtësi organizative, aftësi për të marrë iniciativa dhe për punë ekipore;<br>- të planifikojnë dhe të menaxhojnë projekte për të arritur objektiva të caktuara (udhëheqje, delegim, analizë, komunikim, raportim, vlerësim, monitorim, mentorim);<br>- të identifikojnë dhe të vlerësojnë resurset e nevojshme (p.sh. kohën, mjetet financiare, burimet njerëzore);<br>- të tregojnë fleksibilitet, kreativitet, kapacitet për t'iu përshtatur rrethanave të reja dhe përgjegjshmëri gjatë realizimit të një detyre;<br>- të manifestojnë vetiniciativë;<br>- të demonstrojnë sensin e solidaritetit dhe të garës së drejtë gjatë realizimit të detyrave të caktuara. |

### Kompetencat personale ("Individ i shëndetshëm")

Për të zhvilluar kompetencat personale, shkollat përgatisin nxënësit që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen që të vetëdijesohen për veten dhe të kenë vetëbesim, por njëkohësisht të jenë të hapur dhe të kenë besim te të tjerët.

| Kompetencat personale, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënit |
|---|
| Me rastin e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:<br>- të demonstrojnë vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale;<br>- të njohin përparësitë dhe dobësitë e tyre, të përparojnë tutje duke u mbështetur në përparësitë e tyre dhe të punojnë për kapërcimin e dobësive;<br>- të njohin dhe të menaxhojnë emocionet e tyre;<br>- të bashkëpunojnë dhe të bashkëndiejnë me të tjerët;<br>- të njohin, të respektojnë dhe të çmojnë kulturën e tyre si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve;<br>- të flakin paragjykimet dhe të bëjnë kompromise;<br>- të menaxhojnë stresin, traumat dhe të zgjidhin konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive;<br>- të kuptojnë dhe t'u përmbahen kodeve të sjelljes në situata të ndryshme;<br>- të kuptojnë mënyrën e jetës së shëndetshme;<br>- të bëjnë zgjedhje dhe të marrin vendime të informuara lidhur me shëndetin, dietat dhe ushtrimet;<br>- të ndjekin planet personale të jetesës dhe të vlerësojnë nëse i kanë arritur qëllimet e synuara dhe në çfarë niveli;<br>- të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të veta. |

## Kompetencat qytetare ("Qytetar i përgjegjshëm")

Të mësuarit për të jetuar së bashku trajtohet si sfida kryesore e botës së sotme dhe së nesërme. Qytetaria shtetërore sot plotësohet me aspektin shumë të rëndësishëm të "qytetarisë globale". Kjo kompetencë siguron që nxënësit të jenë në gjendje të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë.

| **Kompetencat qytetare, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënit** |
| --- |
| Me rastin e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:<br>- të kuptojnë mjedisin e tyre shoqëror, në nivel lokal dhe më të gjerë dhe mënyrën e funksionimit të tij (p.sh. strukturën, kulturën, shprehitë, rregullat dhe të pritshmet);<br>- të mbështesin të drejtat e njeriut si bazë e demokracisë;<br>- të kuptojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre si dhe të njohin e të respektojnë të drejtat e të tjerëve;<br>- të vlerësojnë diversitetet dhe të demonstrojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;<br>- të menaxhojnë dhe të zgjidhin konfliktet në mënyrë konstruktive;<br>- të marrin pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në të gjitha nivelet (p.sh. në familje, në shkollë, në komunitet lokal/aktivitete të lagjes, si dhe në proceset e politikave lokale dhe shtetërore);<br>- të demonstrojnë vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p.sh. respekti i dinjitetit personal, luftimi i paragjykimeve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve; luftimi i varfërisë dhe i margjinalizimit; promovimi i barazisë gjinore);<br>- të tregojnë interes për çështjet publike dhe të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve në nivel shkolle dhe komuniteti;<br>- të mbrojnë mjedisin natyror dhe artificial dhe të kontribuojnë për zhvillim të qëndrueshëm. |

# 3. Parimet e Kornizës së Kurrikulës

Korniza e Kurrikulës ka një rol rregullues të tërë sistemit të arsimit parauniversitar dhe parimet e përbashkëta sigurojnë koherencën dhe konsistencën e këtij sistemi.

Prandaj, parimet kryesore për udhëheqjen e procesit të hartimit të Kornizës së Kurrikulës do të jenë referenca kryesore edhe për hartimin e Kurrikulës Bërthamë (Kurrikula e përbashkët për të gjithë nxënësit) dhe për hartimin e të gjitha dokumenteve të tjera të Kurrikulës (shih hierarkinë e dokumenteve të Kurrikulës në kapitullin: Komponenti operativ i Kurrikulës).

Parimet për zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës së Kurrikulës në Kosovë janë si vijon:

### Gjithëpërfshirja

Ky parim i referohet së drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor.

E udhëhequr nga ky parim, Korniza e Kurrikulës mundëson zgjidhje të modifikueshme për t'i trajtuar dallimet e nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuuar kështu në zhvillimin e plotë të potencialeve mësimore të secilit. Duke i pasur parasysh nevojat individuale dhe stilet e të nxënit, përvojat mësimore në shkollë do të nxisin motivimin për mësim, si kusht për përmirësimin e vijueshmërisë së shkollës dhe nivelit të arritjes së nxënësve.

Në këtë kontekst, Korniza e Kurrikulës promovon:

(a) të nxënit që reflekton përvojat dhe informacionet paraprake të nxënësve; interesimet, potencialin dhe mundësitë e tyre,

(b) të nxënit kuptimplotë (p.sh. i orientuar në zgjidhje të problemeve praktike nga përditshmëria jetësore) dhe

(c) përfshirjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e përvojave të të nxënit, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e përvojave të caktuara dhe në gjendje për të vlerësuar dhe për të vetëvlerësuar rezultatet vetjake të të nxënit.

## Zhvillimi i kompetencave

Kurrikula Shtetërore do të përcaktojë qartë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, të cilat shoqëria dhe ekspertët arsimorë i konsiderojnë të domosdoshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në Kornizën e Kurrikulës, kompetencat kryesore reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, që pritet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit me përfundimin e shkollës së mesme të lartë.

Në Kurrikulën Bërthamë, kompetencat kryesore do të reflektohen nëpërmjet një sistemi të Rezultateve Esenciale të të Nxënit (REN), që duhen të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit.

Përcaktimi i kompetencave kryesore, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënit, që duhen të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit dhe përcaktimi i kritereve për vlerësimin e nivelit të arritjes sigurojnë:

(a) mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit për të nxënë,

(b) vlerësim të drejtë të nivelit të arritjes së nxënësve,

(c) vlerësim të saktë të cilësisë së arsimit që ofrohet në nivel vendi, komune apo shkolle,

(d) kalim të nxënësve nga një nivel në tjetrin, nga një shkollë në tjetrën, apo nga një lloj shkolle në tjetrën.

Përcaktimi i rezultateve të pritura, që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit, njëkohësisht mundëson edhe akreditimin e programeve të ndryshme arsimore, që ofrohen në kuadër të arsimit joformal. Me këtë njëkohësisht mundësohet edhe lëvizshmëria ndërmjet arsimit formal dhe joformal, nëpërmjet procesit të njohjes së dijes paraprake, me të cilën do të përfitojë dukshëm arsimimi i të rriturve dhe format e tjera të arsimit joformal.

## Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe koherent

Korniza e Kurrikulës promovon të nxënit e plotë, që reflekton ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që ne kemi për to.

Në këtë kontekst, Kurrikula do të përfshijë:

(a) rekomandime të qarta mbi planifikimin e përvojave mësimore për të mbështetur nxënësit gjatë tërë sistemit të arsimit parauniversitar drejt zotërimit të kompetencave të përcaktuara dhe

(b) kriteret e vlerësimit për të konstatuar saktësisht nivelin e arritjes së nxënësve në periudha të caktuara kohore.

Për të mundësuar një qasje të tillë, Korniza e Kurrikulës parasheh:

- Promovimin e të nxënit të integruar nëpërmjet fushave të gjera kurrikulare, në kuadër të të cilave përmbajtja lëndore është e ndërlidhur me çështjet ndërkurrikulare dhe kontribuon në zhvillimin e kompetencave kryesore (për shembull, integrimi i shkencave natyrore dhe integrimi i shkencave shoqërore në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët);
- Përforcimin e ndërlidhjes ndërmjet fushave të ndryshme kurrikulare në funksion të një procesi të plotë dhe të shumanshëm mësimor, duke u mundësuar nxënësve konfirmimin e ndërlidhjes së të gjitha aspekteve të procesit mësimor, të të gjitha përvojave mësimore në kuadër të fushave të ndryshme kurrikulare.
- Ndërlidhjen kuptimplotë ndërmjet aspektit konceptual dhe dimensioneve praktike, si zbatimi i dijes dhe shfrytëzimi i shkathtësive, i qëndrimeve dhe i vlerave të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale të jetës së përditshme.
- Integrimin e fushave të reja kurrikulare, që reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore apo të shkencës.
- Perspektivën e të nxënit gjatë gjithë jetës: Kurrikula do t'i përgatisë nxënësit që të ballafaqohen me sukses në jetën e tyre të përditshme me sfidat e vazhdueshme dhe mundësitë që ofron një shoqëri e dijes dhe të nxënit, duke u kushtuar vëmendje të veçantë kompetencave kreative, si: mësimit për të nxënë, kompetencave për vlerësimin dhe procedimin efektiv e të ndërgjegjshëm të informacionit, të nxënit elektronik dhe kompetencat për shfrytëzimin e teknologjive aktuale dhe të ardhshme të epokës digjitale (si: teknologjia e komunikimit dhe e informimit, të nxënit elektronik, jo si një lëndë e veçantë, por si mënyrë e të menduarit dhe e të vepruarit, vetëdijesimi për mediet, shkathtësitë proaktive jetësore).

## Autonomia dhe fleksibilitet në nivel shkolle

Korniza e Kurrikulës është përcaktuar për një sistem i cili rregullon qartë normat e autonomisë dhe të fleksibilitetit të shkollës.

Autonomia dhe fleksibiliteti për zbatimin e Kurrikulës në nivel shkolle kanë të bëjnë me mundësinë dhe përgjegjësinë e shkollës për:

- Hartimin vjetor të planit mësimor dhe shfrytëzimin fleksibil të kohës shkollore, duke mundësuar forma të mësimdhënies interaktive; Kurrikula Bërthamë për shkallët e Kurrikulës do të përcaktojë përqindjen minimale të fondit të orëve për secilën fushë kurrikulare (periudha që përfshijnë dy-tri vite shkollore), përderisa planet mësimore për lëndët e veçanta gjatë një viti shkollor do të përpilohen në nivel shkolle.

- Planifikimin dhe shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të Kurrikulës, përfshirë mundësinë për:

  (a) rritjen e fondit të orëve në kuadër të fushave përkatëse kurrikulare dhe

  (b) zhvillimin dhe zbatimin e elementeve plotësuese kurrikulare për të përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve të saj si dhe për të reflektuar rrethanat në të cilat shkolla përkatëse vepron.

## Përgjegjësia dhe llogaridhënia

Korniza e Kurrikulës, krahas promovimit të autonomisë dhe fleksibilitetit në nivel shkolle, parasheh edhe vendosjen e një mekanizmi të qartë të llogaridhënies për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit. Përgjegjësia dhe llogaridhënia i referohen para së gjithash procesit të zbatimit të Kornizës së Kurrikulës si dhe sistemit të arsimit në tërësinë e tij.

Gjatë procesit të zbatimit të Kurrikulës, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe krijimit të një kulture të vlerësimit të vazhdueshëm, që nënkupton idenë që ndjekja e progresit në zbatimin e kërkesave të Kurrikulës të bëhet pjesë normale e funksionimit të shkollave. Në suaza të këtij procesi, kuadri mësimor, kuadri drejtues i shkollave dhe autoritetet komunale të arsimit do të përfshihen në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt një paraqitjeje me të mirë në përmbushjen e kërkesave të Kurrikulës dhe ngritjes së cilësisë së arsimit.

Në këtë kontekst, zbatimi i Kurrikulës Shtetërore në nivel shkolle parasheh:

- Angazhim aktiv të shkollës në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të përvojave të mësimdhënies dhe të të nxënit drejt ngritjes së nivelit të arritjeve të nxënësve;
- Angazhim të shkollave dhe komunave në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt përmbushjes së kërkesave të Kurrikulës Shtetërore;
- Zinxhir të qartë të mbështetjes, raportimit dhe llogaridhënies.

# 4. Korniza e Kurrikulës nëpër nivelet e arsimit: shkallët e Kurrikulës dhe roli i tyre në organizimin e punës edukativo-arsimore në shkollë

Korniza e Kurrikulës është hartuar në përputhje me strukturën e re të arsimit, që përfshin nivelet arsimore në vijim:

| Nivelet sipas SNKA[1] | Struktura e arsimit të Kosovës | Moshat |
|---|---|---|
| | Arsimimi i të rriturve/Arsimimi gjatë tërë jetës në shkallë të gjerë (formal dhe joformal) | 23/24+ |
| SNKA 6 | Arsimi pasuniversitar | 23/24+ |
| SNKA 5 | Arsimi universitar[2] | |
| SNKA 4 | Arsimi passekondar jouniversitar | 18 + |
| SNKA 3 | Arsimi i mesëm i lartë<br>Klasat X-XII | 15-17 |
| SNKA 2 | Arsimi i mesëm i ulët<br>Klasat VI-IX | 11-14 |
| SNKA 1 | Arsimi fillor<br>Klasat I-V | 6-10 |
| SNKA 0 | Klasa parafillore | 5-6 |
| | Arsimi parashkollor | lindje-5 |

Gjatë niveleve formale të shkollimit, nxënësit në mënyrë koherente përgatiten për mësim gjatë tërë jetës dhe për botën e punës në epokën e dijes të bazuar në digjitalizim.

Krahasuar me Kornizën e Kualifikimeve, Korniza e Kurrikulës u referohet vetëm 4 niveleve formale të arsimit dhe 5 niveleve të kualifikimeve. Me këtë ofrohet një bazë e mirë, një platformë e cila në të njëjtën kohë është dritare e hapur drejt arsimimit gjatë tërë jetës dhe arsimimit të të rriturve. Prandaj, në të gjitha shkallët e Kurrikulës dhe në të gjitha fushat e Kurrikulës do të theksohen mundësitë që u ofrohen nxënësve për të arritur kualifikimet kombëtare të bazuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

1 Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit.
2 Tri pjesët e fundit nuk janë pjesë të arsimit parauniversitar.

## 4.1. Struktura e sistemit të arsimit parauniversitar: veçoritë e niveleve të arsimit dhe ndikimi i tyre në Kurrikulë

Më poshtë janë paraqitur karakteristikat e niveleve të arsimit, ndikimi i tyre në Kurrikulë dhe procesi i të nxënit që ato promovojnë.

### Edukimi parashkollor

Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të edukimit, gjatë të cilit fëmijët edukohen në familjet e tyre ose në institucione parashkollore (mosha 0-3 dhe mosha 3-5) dhe në institucione parashkollore apo në shkolla fillore (mosha 5-6). Edukimi parashkollor mbështetet në standardet e zhvillimit dhe të nxënit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç, standarde të cilat mbështesin dhe nxisin zhvillimin optimal të fëmijëve.

Mosha parashkollore paraqet një periudhë të zhvillimit të shpejtë fizik, njohës, emocional dhe social të fëmijëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj periudhe të zhvillimit në vendosjen e një baze të mirë për të nxënit gjatë gjithë jetës, ekspozimi i fëmijëve ndaj proceseve elementare të të nxënit do të fokusohet në stimulimin e kërshërisë së tyre mbi veten, mbi shoqërinë, mbi natyrën, mbi dijen, mbi kulturën dhe mbi teknologjitë e reja. Synim i punës edukative gjatë kësaj periudhe është edhe stimulimi i kreativitetit dhe entuziazmit në qasjen përvojave të reja dhe përballjen e situatave reale jetësore.

Gjatë këtij niveli të arsimit, fëmijët përkrahen në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit në gjuhën e tyre amtare në situata të thjeshta të përditshmërisë, në zhvillimin e vëmendjes së tyre dhe aftësive të përqendrimit si dhe në zhvillimin e shkathtësive themelore sociale.

Vëmendje e veçantë gjatë kësaj faze i kushtohet edhe zhvillimit fizik nëpërmjet aktiviteteve fizike dhe përvojave që rrisin vetëdijen e fëmijëve për nevojën e mbrojtjes së mirëqenies së tyre fizike si dhe kujdesit për shëndetin e sigurinë.

Në klasën parafillore (mosha 5-6 vjeç), fëmijët do t'u nënshtrohen edhe përvojave të të nxënit, që përfshijnë elementet themelore të leximit, të shkrimit dhe të llogaritjeve numerike, duke rritur kështu gatishmërinë e tyre për shkollë dhe për jetë.

### Klasa parafillore

Kjo klasë përfshin elementet themelore të leximit, të shkrimit dhe të llogaritjes me numra. Nxënësit duhet të njihen me elementet e shkronjave dhe me strukturën e një teksti të thjeshtë, duke shfrytëzuar fotografi/vizatime dhe duke analizuar elemente të pikturës së caktuar. Po ashtu, nxënësit duhet të njihen me numra dhe veprime të thjeshta matematikore; grupimi i elementeve, identifikimi i simboleve matematikore me objekte të ndryshme konkrete dhe zgjidhja e problemeve të thjeshta nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar veprimet matematikore. Te kjo moshë, aktivitetet e lidhura me artet duhet të jenë pjesë e rëndësishme e programit me qëllim të zhvillimit të ndjeshmërisë dhe anës afektive të fëmijëve.

### Arsimi fillor (klasat I - V)

Në këtë nivel, përvojat mësimore në shkollë duhet të kontribuojnë për ambientimin e fëmijëve me një formë më të sistemuar të të nxënit nëpërmjet 'lojës/punës/mësimit', duke filluar të bëjnë dallimin mes lojës dhe obligimeve. Realizimi i procesit mësimor bëhet në mënyrë të integruar, duke mundësuar që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu të kuptohet në mënyrë sa më të plotë.

Gjatë nivelit të arsimit fillor puna edukativo-arsimore përqendrohet në përvetësimin e shkrim-leximit themelor, në vendosjen e një baze të shëndoshë për zhvillimin njohës, socio-emocional dhe motorik. Kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit si bazë për zhvillimin e shprehive themelore për të nxënë, 'mësimi për të nxënë'.

Procesi mësimor në arsimin fillor organizohet, ofrohet, lehtësohet dhe bashkërendohet nga mësimdhënësi klasor, i ndihmuar, sipas nevojës, nga mësimdhënës-asistentë dhe me mundësi të përkrahjes nga mësimdhënësit e specializuar lëndorë.

### Arsimi i mesëm i ulët (klasat VI-IX)

Arsimi i mesëm i ulët u ofron nxënësve sfida të reja për zhvillimin e tyre nga aspekti njohës, fizik, personal, social dhe moral. Kërshëria e natyrshme e nxënësve nxitet tutje për të siguruar që dija, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e zotëruara në këtë nivel të paraqesin një bazë të qëndrueshme për nivele më të larta të arsimit.

Në këtë nivel – duke e plotësuar 'shkrim-leximin themelor', i cili pritet të përvetësohet në nivelin paraprak të shkollimit, nxënësit përkrahen që në mënyrë graduale ta përforcojnë këtë alfabetizim, duke e bërë funksional dhe të qëndrueshëm përgjatë tërë jetës në aspekte të ndryshme: të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë. Kjo në thelb nënkupton të nxënit për t'iu qasur informatës në mënyrë efikase dhe efektive, për të vlerësuar informatën në mënyrë kritike e me kompetencë dhe për të shfrytëzuar informatën në mënyrë të saktë dhe kreative.

Alfabetizimi vizual dhe ai digjital janë po aq të rëndësishëm në këtë nivel. Alfabetizimi vizual i referohet aftësimit të nxënësve për të deshifruar, për të interpretuar dhe për të zbuluar mostrat dhe modelet e dijes si dhe për të shfrytëzuar imagjinatën vizuale për komunikimin e ideve. Ndërkaq, alfabetizimi digjital ndihmon efikasitetin e shfrytëzimit të kohës dhe kreativitetin në të shprehurit dhe komunikimin e ideve, gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve të shumta të informacionit gjatë procesit mësimor (bibliotekat elektronike, ueb faqet e ndryshme shkencore, mediet e besueshme etj.), sistemimin dhe ruajtjen e materialeve dhe detyrave mësimore në formën elektronike, kalkulimet e shpejta dhe të sakta etj.

Në këtë nivel, Kurrikula pasurohet duke i vënë nxënësit para një spektri më të gjerë të përvojave të të nxënit (p.sh. kombinimi i qasjeve konceptuale dhe praktike; të menduarit abstrakt dhe veprimet e kontekstualizuara, kontakti me realitetin konkret dhe virtual), në mënyrë që ata të ndihmohen në identifikimin e preferencave të tyre dhe fushave të interesit.

Në arsimin e mesëm të ulët nxënësit përgatiten më thellësisht për orientim në karrierë

duke u përkrahur me mentorë/këshilltarë profesionalë, të cilët udhëzojnë nxënësit në njohjen dhe zhvillimin e interesave të tyre personale për të nxënë dhe në përcaktimin përshtatshëm të pritshmërisë së tyre në të ardhmen.

### Arsimi i mesëm i lartë (klasat X-XII)

Arsimi i mesëm i lartë bazohet në një proces më të gjerë, më të thellë dhe më të specializuar të të nxënit, duke pasur parasysh:

(a) orientimin e ardhshëm të nxënësve drejt studimeve akademike, drejt kualifikimeve profesionale (përfshirë arsimin postsekondar jouniversitar) dhe/apo inkuadrimin në tregun e punës si punëtorë të kualifikuar, si dhe

(b) nevojën për t'i pajisur ata me shkathtësi për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Në këtë nivel, si në shkollat e përgjithshme (gjimnazet), ashtu edhe në shkolla profesionale, procesi i përvetësimit të dijeve dhe zhvillimit të shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve bazohet në nevojën e të rinjve për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë si qytetarë aktivë dhe kompetentë në zhvillimet shoqërore dhe për t'u inkuadruar me sukses në tregun e punës. Prandaj, nxënësit i nënshtrohen një procesi më sfidues të përvetësimit të dijeve, zhvillimit të potencialit të tyre intelektual, emocional dhe fizik.

### Arsimi postsekondar jouniversitar

Arsimi postsekondar jouniversitar është nivel i shkollimit pas shkollës së mesme të lartë dhe kandidatët duhet të jenë mbi moshën 18 vjeç. Në sistemin ndërkombëtar të klasifikimit të arsimit, sistemohet në nivelin SNKA 4. Në Kosovë, ky lloj i shkollimit ofrohet nga institucionet e shkollave të mesme teknike, nga shkollat e larta profesionale, por edhe nga institucionet e arsimit universitar.

Niveli i shkollimit postsekondar jouniversitar ofron specializime profesionale, profesione ndërsektoriale, profesione të përgjithshme dhe arsim të lartë të përgjithshëm. Këtë nivel mund ta vijojnë nxënësit që përfundojnë shkollat profesionale dhe të përgjithshmet, në të cilat vijuesit aftësohen për kompetenca profesionale në fusha të ndryshme. Për profesione të caktuara këto kompetenca mund të jenë të përkufizuara me standarde ndërkombëtare, në të kundërtën përkufizohen nga autoriteti shtetëror për kualifikime - Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në Kosovë, diplomat e fituara për këtë nivel të arsimimit janë të nivelit 5 të kualifikimeve, të cilat shërbejnë për të dalë në treg të punës, ose për t'u rikualifikuar për punë të caktuar. Kandidatët që tregojnë sukses të lartë në këtë nivel të arsimit, fitojnë të drejtën për t'u regjistruar në studimet universitare edhe pa e arritur minimumin e kërkuar në testin e maturës.

Institucionet e arsimit postsekondar kanë instrumentet dhe organet për certifikim të kandidatëve të cilët kanë përvojë të caktuar dhe rezultate konkrete në punë, por nuk posedojnë diplomë që dëshmon kualifikimin e tyre. Për këtë shërbim, institucionet do të organizojnë procesin e njohjes së dijes paraprake, në harmoni me kërkesat dhe rregullat e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK).

## 4.2. Shkallët e Kurrikulës dhe roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e punës edukativo-arsimore në shkollë

Korniza e Kurrikulës është e strukturuar sipas gjashtë shkallëve të Kurrikulës, të cilat paraqesin periudha me karakteristika të përbashkëta për sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave të Kurrikulës. Ato paraqesin pikën referuese për përcaktimin e kompetencave kryesore që duhen zotëruar, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave mësimore, qasjen dhe kriteret e vlerësimit si dhe institucionin përgjegjës për arritjen e tyre.

Strukturimi dhe organizimi i Kurrikulës sipas shkallëve të Kurrikulës mundëson:

- respektimin e karakteristikave të periudhave të ndryshme zhvillimore të fëmijëve me rastin e përcaktimit të qëllimeve specifike dhe kompetencave që duhen zotëruar nga fëmijët;
- respektimin e ritmeve individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të parapara për shkallën e caktuar të Kurrikulës;
- sigurimin e një qartësie më të lartë në artikulimin e rezultateve të pritura të të nxënit gjatë shkallëve të Kurrikulës si pikë referuese për planifikimin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore në nivel shkolle;
- sigurimin e një fleksibiliteti të shtuar në planifikimin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore nëpërmjet zgjerimit të ciklit të planifikimit nga një vit shkollor në dy/tri vite shkollore (varësisht nga shkalla e Kurrikulës);
- sigurimin e udhëzimeve specifike për organizimin e punës edukativo-arsimore gjatë shkallëve të Kurrikulës, me theks të posaçëm në metodat e punës dhe format e vlerësimit;
- rritjen e llogaridhënies së shkollës dhe autoriteteve lokale të arsimit për cilësinë e arsimit që ofrohet në nivel shkolle.

<table>
<tr><th>Sistemi Ndër. i Klasifikimit</th><th>Nivelet e sistemit formal të arsimit</th><th>Shkallët e Kurrikulës</th></tr>
<tr><td rowspan="2">SNKA 3</td><td>Arsimi i mesëm i lartë<br>Klasa XII</td><td>Shkalla e Kurrikulës 6:<br>Konsolidim dhe specializim</td></tr>
<tr><td>Arsimi i mesëm i lartë<br>Klasat X-XI</td><td>Shkalla e Kurrikulës 5:<br>Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional</td></tr>
<tr><td rowspan="2">SNKA 2</td><td>Arsimi i mesëm i ulët<br>Klasat VIII-IX</td><td>Shkalla e Kurrikulës 4:<br>Përforcim dhe orientim</td></tr>
<tr><td>Arsimi i mesëm i ulët<br>Klasat VI-VII</td><td>Shkalla e Kurrikulës 3:<br>Zhvillim i mëtejmë dhe orientim</td></tr>
<tr><td rowspan="2">SNKA 1</td><td>Arsimi fillor, Klasat III-V</td><td>Shkalla e Kurrikulës 2: Përforcim dhe zhvillim</td></tr>
<tr><td>Arsimi fillor, Klasat I-II</td><td rowspan="2">Shkalla e Kurrikulës 1: Përvetësim themelor</td></tr>
<tr><td rowspan="2">SNKA 0</td><td>Klasa parafillore</td></tr>
<tr><td>Mosha 0-5</td><td>Shkalla përgatitore e Kurrikulës:<br>Edukimi në fëmijërinë e hershme</td></tr>
</table>

### Shkalla përgatitore e Kurrikulës: Edukimi në fëmijërinë e hershme

Kjo shkallë përfshin periudhën e fëmijës prej lindjes deri në klasën parafillore. Gjatë kësaj shkalle, nëpërmjet lojës, fëmijët përkrahen në zhvillimin e hershëm personal, përfshirë:

- zhvillimin e aftësive për të komunikuar në gjuhën amtare nëpërmjet aktiviteteve që ndihmojnë artikulimin e drejtë të fjalëve, pasurimin e fjalorit dhe ushtrimin e aftësisë për të dëgjuar të tjerët;
- zhvillimin fizik dhe ushtrimin e koordinimit të lëvizjeve trupore, zhvillimin e forcës, të ekuilibrit, zhvillimin e muskujve të vegjël, koordinimin sy-dorë dhe aftësimin e manipulimit me objekte të ndryshme të përdorimit ditor;
- vetëdijesimin gradual për veten, për të tjerët dhe për mjedisin që i rrethon;
- zhvillimin e aftësive për të respektuar rregullat, për të dalluar të drejtën nga e gabuara dhe për të dalluar veprimet që lejohen prej atyre që janë të ndaluara;
- nxitjen dhe aftësimin për t'u angazhuar në mënyrë aktive në aktivitete praktike, për të vlerësuar rreziqet dhe për të respektuar rregullat elementare të higjienës dhe sigurisë.

### Shkalla e Kurrikulës 1 – Përvetësim themelor

Kjo shkallë përfshin klasën parafillore, klasën I dhe klasën II. Në këtë shkallë vendoset baza për të nxënit sistematik dhe procesi edukativo-arsimor përqendrohet në:

- njohjen dhe të kuptuarit e të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësive në klasë, në shkollë dhe në familje;
- përvetësimin e elementeve themelore të shkrim-leximit në gjuhën amtare dhe të llogaritjeve numerike;
- mësimin fillestar të gjuhës angleze;
- hulumtimin e mjedisit në mënyrë më sistematike;
- përmbushjen e detyrave të caktuara, duke respektuar afatet e përcaktuara kohore;
- përballja individuale dhe si pjesë e një grupi e përvojave të ndryshme të të nxënit.

### Shkalla e Kurrikulës 2 - Përforcim dhe zhvillim

Kjo shkallë përfshin klasat III, IV dhe V. Në këtë shkallë nxënësit duhet të përkrahen për të konsoliduar përvetësimet themelore në lexim, shkrim, komunikim dhe teknika të të nxënit, si bazë për zhvillim të mëtejshëm.

Në këtë shkallë fëmijët u nënshtrohen sfidave si në vijim:

- shfrytëzimit të drejtë të gjuhës amtare dhe të gjuhës angleze në komunikim verbal dhe me shkrim;
- shfrytëzimit të drejtë të simboleve dhe operacioneve;
- shpalosjes së fushave të reja të dijes dhe thellimit të informacioneve;

- ❑ zhvillimit të aftësive për të menduar, për të strukturuar dhe për të orientuar zgjidhjen e problemeve;
- ❑ të kuptuarit e përgjegjësisë për vetveten, për të tjerët dhe për mjedisin;
- ❑ zgjerimit të burimeve të dijes;
- ❑ kultivimit të pavarësisë në planifikimin dhe realizimin e detyrave;
- ❑ ndërlidhjes së dijes teorike me problemet praktike;
- ❑ zhvillimit të qëndrimit pozitiv ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve;
- ❑ zhvillimit të qasjes kritike zgjidhjes së problemeve.

### Shkalla e Kurrikulës 3 – Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim

Kjo shkallë përfshin klasën VI dhe VII. Synon thellimin e dijeve në kuadër të fushave të ndryshme kurrikulare, duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik dhe në karrierë. Nxënësit u nënshtrohen sfidave për:

- ❑ zhvillimin e të menduarit abstrakt dhe kompleks (p.sh. shkathtësive të larta intelektuale), që është i nevojshëm për të njohur botën dhe veten si dhe për zgjidhje të problemeve;
- ❑ kultivimin e interesimit për njohje më të thellë të vetes, të tjerëve dhe mjedisit natyror e shoqëror;
- ❑ zhvillimin e shkathtësive për vetëvlerësim;
- ❑ zhvillimin e shkathtësive për komunikim efektiv, përfshirë edhe kodet matematikore dhe shkencore;
- ❑ zgjerimin e mundësive për komunikim verbal dhe të shkruar në gjuhën e tyre amtare, në gjuhën angleze dhe në gjuhën e dytë të huaj/njërën nga gjuhët zyrtare;
- ❑ zhvillimin e përgjegjshmërisë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe për mbrojtje të mjedisit.

### Shkalla e Kurrikulës 4 – Përforcim dhe orientim

Përfshin klasat VIII dhe IX. Kjo shkallë synon t'i orientojë nxënësit që të marrin parasysh mundësitë e ndryshme të karrierës. Ata ballafaqohen me sfida që kanë të bëjnë me:

- ❑ shfrytëzimin e burimeve të informacionit dhe qasjes kritike të dhënave të ndryshme;
- ❑ zhvillimin e interesit për jetën publike nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë në aktivitete të ndryshme jashtëshkollore;
- ❑ përballjen e çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me tema nga jeta reale përmes projekteve që do t'u mundësojnë konsolidimin e dijeve të tyre dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive dhe qëndrimeve;
- ❑ familjarizimin me mundësitë e ndryshme të studimit dhe orientimit në karrierë;
- ❑ përgatitjen praktike dhe aktivitetet orientuese që u mundësojnë nxënësve të qartësojnë aspiratat e tyre;

- përforcimin e shkathtësive të vetëvlerësimit;
- përforcimin e kompetencave për punë të pavarur individuale dhe ekipore.

### Shkalla e Kurrikulës 5 - Arsim i përgjithshëm dhe arsim profesional

Përfshin klasat X dhe XI. Kjo shkallë synon t'i ballafaqojë nxënësit me studime më të thella dhe më të specializuara të nxënies, në kuptim të përgatitjes akademike për arsim të lartë dhe/apo për të hyrë në tregun e punës. Nxënësit u ballafaqohen me sfida që u mundësojnë:

- zhvillimin e vetëbesimit;
- studimin më të thellë dhe më të specializuar, duke angazhuar aftësitë për shfrytëzim të burimeve të ndryshme, me një qasje kritike të dhënave të ndryshme në dispozicion;
- zhvillimin e dëshirës për përkushtim dhe qëndrueshmëri për arritje më të larta, në kuptim të mësimit dhe përgatitjes për karrierë si dhe për jetë personale, profesionale dhe publike;
- përgatitjen për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore si qytetarë të përgjegjshëm dhe kompetentë dhe për të garuar me sukses në tregun e punës. Zhvillimin si individë dhe anëtarë të shoqërisë, të aftë dhe me kapacitete të nevojshme për jetë dhe punë që të përballin ndryshimet e ekonomisë lokale dhe globale dhe të mësojnë se si të bëjnë zgjidhjen e problemeve në situata të ndryshme në jetën personale dhe profesionale;
- përgatitjen për jetë, që të jetojnë të pavarur dhe të punojnë në përballimin e sfidave dhe mundësive që ofron shoqëria bashkëkohore dhe të marrin veprime dhe vendime të përgjegjshme për situata, të informuar mirë gjatë gjithë jetës së tyre.

### Shkalla e Kurrikulës 6 – Konsolidim dhe specializim

Kjo shkallë përfshin klasën XII. Kjo është fazë e kalimit nga adoleshenca në fazë të pjekurisë, gjatë së cilës nxënësit duhet të konsolidojnë përvojën e përgjithshme të shkollimit të detyrueshëm dhe të përgatiten për kërkesat e një faze të re të jetës dhe arsimimit të lartë. Nxënësit në programet e shkollave të mesme do të përgatiten për t'u inkuadruar në tregun e punës si punëtorë të shkathët. Nxënësit do t'u ekspozohen sfidave për:

- demonstrimin e aftësive për identifikimin e burimeve të domosdoshme dhe për qasjen kritike të dhënave të ndryshme;
- demonstrimin e aftësisë për vendimmarrje të pavarur dhe për marrjen e përgjegjësive për zgjedhjet dhe veprimet personale;
- demonstrimin e përkushtimit të tyre për angazhim të vazhdueshëm për të nxënë, për studim të mëtutjeshëm dhe/apo për zhvillim profesional;
- demonstrimin e shkathtësive për të zhvilluar dhe për të promovuar strategji për planifikimin e karrierës nëpërmjet kërkimit të shembujve dhe inovacioneve, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e idesë së ndërmarrësisë;
- demonstrimin e shkathtësive për ndryshimin e konceptit të karrierës, nëpërmjet

kërkimit në një spektër më të gjerë të punëve, duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të transferueshme për mundësitë e karrierës në të ardhmen;

- angazhimin në procesin e planifikimit të karrierës personale nëpërmjet hulumtimit lidhur me mundësitë e kualifikimit postsekondar, duke pranuar se qëndrimet dhe nevojat për punë dhe vendimmarrje do të ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme.

# 5. Fushat, lëndët dhe modulet mësimore në nivele dhe shkallë të Kurrikulës

Kurrikula e Kosovës është strukturuar në shtatë fusha, të përkufizuara si fusha të Kurrikulës. Fushat e Kurrikulës përbëjnë bazën për zhvillimin e kompetencave kryesore të përcaktuara me dokumentin e Kornizës së Kurrikulës nga fëmijëria e hershme deri në arsimin e mesëm të lartë. Këto vlejnë si për arsimin e mesëm të lartë të përgjithshëm ashtu edhe për arsimin profesional. Lidhjet ndërmjet fushave, lëndëve dhe moduleve të Kurrikulës duhet të jenë në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore.

## 5.1. Fushat e Kurrikulës dhe lëndët mësimore

Fushat e Kurrikulës përbëjnë bazën për organizimin e procesit edukativo-arsimor në shkollë në nivele dhe shkallë përkatëse të Kurrikulës

**Fushat e Kurrikulës:**

- Gjuhët dhe komunikimi
- Artet
- Matematika
- Shkencat natyrore
- Shoqëria dhe mjedisi
- Shëndeti dhe mirëqenia
- Jeta dhe puna

Për secilën fushë kurrikulare përcaktohen rezultatet e të nxënit, të cilat do të mundësojnë arritjen e kompetencave kryesore.

Fushat mësimore përfshijnë një ose disa lëndë apo module mësimore. Lëndët dhe modulet mbështeten në qëllimet dhe rezultatet mësimore të përcaktuara për fushën përkatëse kurrikulare. Disa lëndë të një fushe kurrikulare mund të paraqiten si të integruara në shkallë të ndryshme të Kurrikulës.

**Tabela e mëposhtme paraqet shtrirjen e fushave kurrikulare nëpër nivelet dhe shkallët e Kurrikulës.**

| Fushat e Kurrikulës | Lëndët mësimore përgjatë shkallëve të Kurrikulës (ShK) | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Parashkolla | ShK 1 | ShK2 | ShK3 | ShK4 | ShK5 | | ShK6 | |
| | Grupmoshat:<br><br>0-3 vjeç<br>4-5 vjeç | Klasat: Parafillore, I, II | Klasat III, IV dhe V | Klasat VI dhe VII | Klasat VIII dhe IX | Klasat X dhe XI<br><br>(Arsimi i përgjithshëm) | Klasa X dhe XII<br><br>(Arsimi dhe aftësimi profesional AAP) | Klasa XII<br><br>(Arsimi i përgjithshëm) | Klasa XII<br><br>(Arsimi dhe aftësimi profesional – AAP) |
| **Gjuhët dhe komunikimi** | Aktivitete që nxisin komunikimin gjuhësor | Gjuhë amtare<br><br>Gjuhë angleze | Gjuhë amtare<br><br>Gjuhë angleze<br><br>Gjuha e dytë | Gjuhë amtare<br><br>Gjuhë angleze<br><br>Gjuha e dytë | Gjuhë amtare<br><br>Gjuhë angleze<br><br>Gjuha e dytë | Gjuhë amtare<br><br>Gjuhë angleze<br><br>Gjuha e dytë<br><br>Gjuhë të tjera | Gjuhë amtare<br><br>Gjuhë angleze<br><br>Gjuhë të tjera | Gjuhë amtare<br><br>Gjuhë angleze<br><br>Gjuha e dytë<br><br>Gjuhë të tjera | Gjuhë amtare<br><br>Gjuhë angleze<br><br>Gjuhë të tjera |
| **Artet** | Aktivitete që nxisin shkathtësitë e komunikimit dhe të shprehurit artistik | Edukatë figurative<br><br>Edukatë muzikore | Edukatë figurative<br><br>Edukatë muzikore | Edukatë figurative<br><br>Edukatë muzikore | Edukatë figurative<br><br>Edukatë muzikore | Edukatë figurative<br><br>Edukatë muzikore | Arte aplikative | Edukatë figurative<br><br>Edukatë muzikore | Arte aplikative |
| **Matematika** | Aktivitete që nxisin gjykimin, shkathtësitë numerike | Matematikë | Matematikë | Matematikë | Matematikë | Matematikë | Matematikë | Matematikë | Matematikë |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shkencat natyrore** | Aktivitete që nxisin hetimin dhe zbulimin e mjedisit | Shkencat natyrore | Shkencat natyrore | Shkencat natyrore | Shkencat natyrore | Biologji<br>Fizikë<br>Kimi<br>Astronomi | Shkencat natyrore | Biologji<br>Fizikë<br>Kimi<br>Astronomi | Shkencat natyrore |
| **Shoqëria dhe mjedisi** | Aktivitete që nxisin ndërgjegjësimin për veten dhe për të tjerët dhe zhvillimin e shkathtësive sociale | Shoqëria dhe mjedisi | Shoqëria dhe mjedisi | Shoqëria dhe mjedisi | Shoqëria dhe mjedisi | Histori<br>Gjeografi<br>Edukatë qytetare<br>Sociologji<br>Psikologji<br>Filozofi | Shoqëria dhe mjedisi | Histori<br>Gjeografi<br>Edukatë qytetare<br>Sociologji<br>Psikologji<br>Filozofi | Shoqëria dhe mjedisi |
| **Shëndeti dhe mirëqenia** | Aktivitete që nxisin zhvillimin e shkathtësive fizike dhe të shprehive të higjienës | Shëndeti dhe mirëqenia<br>Edukata fizike | Shëndeti dhe mirëqenia<br>Edukata fizike | Shëndeti dhe mirëqenia<br>Edukata fizike | Shëndeti dhe mirëqenia<br>Edukata fizike | Shëndeti dhe mirëqenia<br>Edukata fizike | Shëndeti dhe mirëqenia<br>Edukata fizike | Shëndeti dhe mirëqenia<br>Edukata fizike | Shëndeti dhe mirëqenia<br>Edukata fizike |
| **Jeta dhe puna** | Aktivitete që nxisin kapacitetet për të kuptuar dhe për të ndjekur procedurat dhe rregullat, kërshërinë, kreativitetin dhe të nxënit në mënyra të ndryshme | Jeta dhe puna | Jeta dhe puna | Jeta dhe puna | Jeta dhe puna | Jeta dhe puna | Jeta dhe puna | Jeta dhe puna | Jeta dhe puna |

## Gjuhët dhe komunikimi

Fusha **Gjuhët dhe komunikimi** u mundëson nxënësve që të zhvillojnë dhe të kultivojnë përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi në jetën e përditshme, në jetën profesionale dhe në jetën publike. Nëpërmjet kësaj fushe kurrikulare, secila lëndë duhet t'i arrijë të gjitha kompetencat e përcaktuara në Kurrikulë.

Kjo fushë kurrikulare përfshin lëndët: gjuhët amtare, gjuhën e parë të huaj (gjuha angleze), gjuhët e mjedisit si dhe gjuhët e tjera të huaja.

Secila lëndë mësimore (gjuhë) në kuadër të kësaj fushe përfshin edhe letërsinë, si pjesë e veçantë e përdorimit të gjuhës në raport me vlerat estetike.

**Gjuha amtare,** mësohet nëpër të gjitha shkallët e Kurrikulës, që nga klasa parafillore e deri te klasa XII.

**Gjuha angleze** fillon nga shkalla e parë dhe mësohet deri në klasën e fundit të shkollës së mesme të lartë. Në shkallën e parë kjo gjuhë mësohet kryesisht nëpërmjet lojës, vizatimeve dhe këngëve, për të vazhduar me leximin dhe shkrimin në shkallët e tjera të Kurrikulës. Gjuha angleze, në nivelin e shkollës së mesme, në dy shkallët e fundit të Kurrikulës, do të mësohet si lëndë e aplikuar në fushat e tjera dhe kjo sidomos në shkollat e arsimit profesional.

**Gjuha shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare** mësohet që nga shkalla e dytë e Kurrikulës.

**Gjuha e dytë** fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa e gjashtë). Si gjuhë e dytë mund të jetë: njëra nga gjuhët e mjedisit (gjuha serbe, boshnjake, turke) zgjedhje e lirë e nxënësve dhe/ose gjuha gjermane, gjuha frënge, gjuha italiane dhe tjetër.

**Gjuhët e tjera** fillojnë në shkallën e pestë të Kurrikulës, d.m.th. në shkollën e mesme të lartë (gjimnaze dhe shkolla profesionale). Në këtë grup përfshihen gjuha gjermane, gjuha frënge, italiane, spanjolle dhe/ose gjuhët klasike (gjuha latine, gjuha e vjetër greke apo ndonjë gjuhë tjetër).

## ARTET: Edukata figurative dhe Edukata muzikore

Prej shkallës së parë e deri te përfundimi i shkallës së gjashtë të Kurrikulës, të gjitha aspektet e të mësuarit në artet shprehëse përfshijnë mundësitë për të realizuar dhe për të shfaqur punë artistike.

Fusha mësimore Artet, siguron që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë perceptuese nëpërmjet formave të zhvillimit të aftësive të të kuptuarit dhe shkathtësive mendore krijuese. Të zhvillojnë aftësitë për marrjen e koncepteve në vizatim, pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn, vallëzim, interpretim dhe muzikë.

Kjo fushë, luan rol të rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e plotë të fëmijëve dhe të

rinjve, duke ndihmuar që të kuptojnë, të shprehin përvojat e tyre personale, të kultivojnë talentin e tyre krijues, të përvetësojnë konceptet themelore në përdorimin e teknikave apo burimeve të ndryshme artistike; të mësojnë të komunikojnë, tët interpretojnë, të zhvillojnë shkathtësitë e tyre artistike për t'u shprehur, të japin një kontribut në ndryshimin shoqëror dhe në zhvillimin e elementeve artistike dhe të informacionit.

Zhvillon aftësitë e nxënësve, duke bërë që ata ta konsiderojnë të shprehurit artistik si një nga aspektet më të rëndësishme të edukimit të tyre.

Fusha mësimore e arteve është  pjesë integrale e procesit të të mësuarit dhe ka lidhje midis imagjinatës dhe inteligjencës, ku  fëmijët marrin pjesë në veprimtari të ndryshme duke zhvilluar më tej krijimtarinë dhe imagjinatën e tyre.

Qëllimi i njohurive të kësaj fushe është zhvillimi i imagjinatës krijuese të figuracionit dhe muzikalitetit, reagimi ndaj shprehjes artistike, e cila konsiston në shumëllojshmërinë e veprimtarive që përfshihen në edukimin artistik.

Artet ndikojnë që nxënësit të zhvillohen në individë me vetëbesim dhe me  aftësi kreative.

Pjesëmarrja e nxënësve në të gjitha format e të shprehurit artistik  mundëson zhvillimin e identitetit individual, por në të njëjtën kohë zhvillon edhe identitetet e tyre grupore.

Diversiteti kulturor, në njërën anë,  dhe trashëgimia kulturore kombëtare, në anën tjetër, duhet të jenë  pjesë integrale të mësimit në arte.

## Matematika

Matematika në Kurrikulë përfaqësohet si fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore. Ajo mundëson zhvillimin  e shkathtësive dhe aftësive të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, zhvillimin e personalitetit të tyre, zhvillimin e shkathtësive për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen e kërshërisë dhe inkurajimit për zbulim, ndërtimin e njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integrimit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Matematika mësohet në të gjitha shkallët e Kurrikulës. Në shkallën e parë dhe të dytë bëhet një lidhje e njohurive për numrat, figurat gjeometrike, pozitën në hapësirë, matjet dhe shkathtësitë për llogaritje e zgjidhje të problemeve. Në shkallën e tretë dhe të katërt kjo lidhje integrohet me njohuritë nga algjebra, gjeometria dhe statistika, kurse në shkallën e pestë dhe të gjashtë sigurohet një zgjerim dhe thellim i njohurive edhe nga trigonometria, analiza matematike dhe probabiliteti.

Një nga aspektet më të rëndësishme në të gjitha shkallët është integrimi i matematikës me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare me qëllim të zotërimit të kompetencave kryesore. Në shkallën e pestë dhe të gjashtë, matematika është në funksion të përgatitjes së nxënësve për studime të mëtejme dhe, në rastin e shkollave profesionale, përfshirja e matematikës së aplikuar mundëson aftësimin e nxënësve për profesione të caktuara.

Nëpërmjet mësimit të matematikës, nxënësit do të marrin njohuri mbi numrat, mbi hapësirën, mbi masat dhe mënyrat e përdorimit të të dhënave (statistikës). Ata do të jenë në gjendje të kuptojnë rolin e të menduarit matematik për zhvillimin e shkencës e të

teknologjisë moderne, si dhe rëndësinë e zbatimit të matematikës në situatat e zgjidhjes së problemeve të llojeve të ndryshme.

## Shkencat natyrore

Shkencat natyrore u mundësojnë nxënësve për të njohur, për të kuptuar, për të hulumtuar natyrën, botën e gjallë e jo të gjallë dhe njeriun, duke filluar nga mikrokozmosi deri në makrokozmos, domethënë në skajet e gjithësisë.

Shkenca është një përpjekje dinamike, bashkëpunuese dhe krijuese e njeriut, që lind nga dëshira për të njohur dhe për të kuptuar botën e cila na rrethon, për të zbuluar të panjohurën, duke hulumtuar fshehtësitë e gjithësisë dhe duke zgjidhur probleme.

Shkencat natyrore përfaqësojnë fushën kurrikulare, që nxënësve u ofron mundësi të zhvillojnë të kuptuarit e koncepteve, të teorive dhe të ligjshmërive fondamentale të natyrës. Ato kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, ndihmojnë në ngritjen e nivelit teknologjik dhe të zhvillimit ekonomik, rritjen e cilësisë së jetës së njeriut, ruajtjen e shëndetit, mjedisit jetësor dhe mirëqenies.

Përmes mësimit (mësimdhënies/nxënies) në shkencat natyrore nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën e kureshtjes dhe të hulumtimit shkencor të mjedisit natyror dhe ndryshimeve të shkaktuara nga aktiviteti i njeriut.

Ata do të aftësohen që t'i zotërojnë fillet e punës shkencore, konceptet, mjetet dhe procedurat, të nxjerrin përfundime të sakta nga analiza e të dhënave, t'i prezantojnë dhe t'i vlerësojnë rezultatet.

Nxënësit do të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve duke përdorur mjete

matëse, në punë individuale dhe ekipore në kuadër të realizimit të programit mësimor apo ndonjë projekti.

Në këtë mënyrë ata do të zhvillojnë mendimin kritik dhe do të aftësohen për identifikimin e problemeve, parashtrimin e pyetjeve, formulimin e hipotezave dhe nxjerrjen e përfundimeve të bazuara në argumente, duke ndjekur hapat e metodologjisë shkencore.

Në SHK1 dhe SHK2 kemi një qasje të integruar të lëndëve (biologji, fizikë, kimi, gjeografi dhe astronomi), ku nxënësit do të mësojnë për mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, metodat shkencore hulumtuese për studimin e proceseve dhe të dukurive natyrore.

Në ShK3 dhe ShK4 ruhet qasja integruese ndërlëndore (fizikë, kimi, biologji).

Në ShK5 dhe ShK6, në shkollat e përgjithshme (në gjimnaze), shkencat natyrore zhvillohen në lëndë të veçanta (fizikë, kimi, biologji dhe astronomi (vetëm në ShK6). Në shkollat profesionale mësimi i shkencave natyrore bëhet nëpërmjet lëndëve të integruara, në funksion të zbatimit të shkencës në profesione të caktuara.

## Shoqëria dhe mjedisi

Përmes fushës 'Shoqëria dhe mjedisi' nxënësit zhvillojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe prirjet që janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike. Kjo ndihmon që të zh-

villojnë të kuptuarit e tyre mbi botën, njerëzit, vlerat e tyre, proceset shoqërore në kohë, vende dhe rrethana të ndryshme. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj fushe ata zhvillojnë edhe të kuptuarit e tyre për mjedisin e vet dhe më gjerë. Kjo do t`u mundësojë atyre që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive e kritike, në komunitetin lokal, kombëtar e global, në të cilin jetojnë e angazhohen, për çështjet shoqërore dhe mjedisore.

Orientimet e ndryshme dhe qasjet tematike të kësaj fushe do të përqendrohen nga perspektiva e arritjes së qëllimeve arsimore, siç janë kultivimi i identitetit personal, shoqëror, kombëtar, identiteti shtetëror e kulturor, të mësuarit për të jetuar së bashku dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Në ShK1 dhe ShK2 mësohet për ndërgjegjësimin dhe marrjen e vendimeve, njohuritë mbi veten dhe shoqërinë dhe të kuptuarit e botës. Në ShK3 dhe ShK4 në kuadër të fushës "Shoqëria dhe mjedisi" trajtohen çështjet shoqërore dhe mjedisore, nëpërmjet mësimit lëndor ose të integruar të lëndëve: Histori, Gjeografi dhe Edukatë qytetare

Në ShK5 dhe ShK6, në shkollat e përgjithshme (gjimnaze), Shoqëria dhe mjedisi realizohet nëpërmjet lëndëve të veçanta: Histori, Gjeografi, Edukatë qytetare, Sociologji, Psikologji, Logjikë dhe Filozofi, duke vënë theksin në zhvillimin e kompetencave përkatëse kryesore në mënyrë të baraspeshuar.

Përvojat mësimore, që kjo fushë ofron në ShK5 dhe ShK6, për nxënësit e shkollave profesionale, përsëri merren nëpërmjet lëndëve shoqërore të integruara, përfshirë aspekte të Edukatës qytetare, Historisë dhe Gjeografisë, të mbështetura në qasje tematike.

Nëpërmjet këtij lëmi të Kurrikulës, nxënësit do të njihen me vlerat dhe normat e jetës shoqërore në një shoqëri demokratike. Ata do t'u qasen gjithashtu dukurive shoqërore nga pikëpamja historike, sociologjike, ekonomike, psikologjike dhe ndërkulturore.

### Shëndeti dhe mirëqenia

Fusha mësimore Shëndeti dhe mirëqenia siguron që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë për mirëqenien e tyre mendore, emocionale, sociale dhe fizike.

Fusha Shëndeti dhe mirëqenia është konceptuar që nëpërmjet saj nxënësit të fitojnë njohuri, të formojnë aftësi, vlera dhe sjellje, të cilat do t'i ndihmojnë ata në përballimin me sukses të jetës së tashme dhe të ardhme.

Përmes kësaj fushe kurrikulare nxënësit do t'i zhvillojnë aftësitë fizike dhe motorike, si dhe aftësitë për të komunikuar dhe për t'u shprehur duke i shfrytëzuar funksionet e trupit. Ata po ashtu do të mund ta zhvillojnë ndjenjën e kujdesit dhe të përgjegjësisë për mirëqenien e vet si dhe për mirëqenien e të tjerëve, duke u kushtuar kujdes mënyrave të shëndosha të jetës dhe duke iu shmangur rreziqeve të çfarëdo lloji. Njëkohësisht, nxënësit do të zhvillojnë aftësi për të bërë lidhje të duhura mes vendimeve, veprimeve dhe pasojave; punës në ekipe, respektimit të rregullave dhe zgjidhjes së problemeve në mënyrë të përshtatshme dhe krijuese.

Fusha mësimore Shëndeti dhe mirëqenia fillon të zbatohet nga shkalla e parë e Kurrikulës dhe është e pranishme deri në shkallën e gjashtë. Në ShK1 dhe ShK2 ofrohet një qasje e integruar në edukatën fizike dhe sporte, si dhe në edukatën shëndetësore, përf-

shirë promovimin e mënyrave të shëndosha të jetesës. Duke filluar nga shkalla e katërt nis mbrojtja prej sëmundjeve dhe rreziqeve dhe edukata seksuale, ndërsa në shkallën e pestë fillon shëndeti reproduktiv, planifikimi dhe edukata familjare.

**Jeta dhe puna**

Fusha e Kurrikulës Jeta dhe puna ofron aktivitete sfiduese, të cilat përfshijnë hulumtimin, zgjidhjen e problemeve, shqyrtimin e koncepteve dhe të nxënit, që rezulton nga krijimi i produkteve të cilat kanë zbatim praktik. Nxënësit do të zhvillojnë kreativitetin e tyre dhe shkathtësi ndërmarrëse dhe do të inkurajohen për të qenë dizajnues inovativë dhe kreativë të së ardhmes. Këto atribute janë thelbësore, kur kemi parasysh se në të ardhmen nxënësit do të luajnë rol të madh në ekonominë globale (për të qenë konkurrentë në tregun e punës) duke përqafuar zhvillimet tekniko-teknologjike të shekullit XXI.

Qëllimi kryesor i të nxënit në fushën Jeta dhe puna është që të aftësojë nxënësit të jenë të informuar, të shkathët, mendimtarë, qytetarë të adaptueshëm dhe ndërmarrës.

Aktivitetet mësimore të kësaj fushe do të realizohen në të gjitha shkallët e Kurrikulës, duke bërë që kompetencat e pritura të arrihen gradualisht.

Në ShK1 dhe ShK2, kjo fushë përqendrohet në Shkathtësitë për jetë, Punëdore dhe Ekonomi shtëpiake. Në ShK3 –ShK6 kjo fushë përfshin Këshillimin dhe orientimin në karrierë, Teknologjinë dhe TIK-un, Edukimin për punë dhe ndërmarrësi.

Në shkollat profesionale, te ShK5 dhe ShK6, fusha Jeta dhe puna përfshin një pjesë më të madhe të fondit të orëve, duke pasur parasysh se të gjitha fushat e tjera të Kurrikulës do të jenë të aplikuara në profesionet përkatëse. Realisht, në këto shkolla fusha Jeta dhe puna, së bashku me pjesën zgjedhore të Kurrikulës, bëjnë 60% të kohës së alokuar dhe ajo kryesisht i dedikohet profilit përkatës profesional.

## 5.2. Fondi i orëve

Fondi i orëve do të ndahet për fusha të ndryshme kurrikulare në mënyrë të baraspeshuar, duke pasur parasysh nevojën për të bërë një përzgjedhje dhe vijimësi të duhur të mësimit në harmoni me moshën e nxënësit dhe nevojat zhvillimore. Në këtë fazë, alokimi i kohës për fusha të ndryshme të Kurrikulës jepet vetëm me përqindje, e cila nënkupton minimumin e kohës së alokuar për fushë. Në një fazë të mëvonshme, te Kurrikula Bërthamë për nivele dhe shkallë të Kurrikulës, do të paraqitet plani mësimor më i specifikuar me fondin e orëve për fusha / lëndë të Kurrikulës.

**Ndarja e kohës për secilën fushë të kurrikulës në përqindje**

| | SNKA 0 | SNKA 1 | | SNKA 2 | | SNKA 3 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Fushat e Kurrikulës | ShK1 | | ShK2 | ShK3 | ShK4 | ShK5&6 Arsimi i përgjith-shëm | ShK5&6 Arsimi dhe aftësimi profesional |
| | Parafillori | Klasa 1 & 2 | | | | | |
| Gjuhët dhe komunikimi | 33.33% | 38.10% | 33.33% | 25.00% | 26.67% | 20.00% | 15.63% |
| Artet | 11.11% | 9.25% | 8.33% | 7.14% | 6.67% | 6.67% | 3.13% |
| Matematika | 22.22% | 23.81% | 20.83% | 17.86% | 13.33% | 13.33% | 9.38% |
| Shkencat natyrore | 5.56% | 4.76% | 8.33% | 14.29% | 16.67% | 16.67% | 6.25% |
| Shoqëria dhe mjedisi | 5.56% | 4.76% | 8.33% | 14.29% | 13.33% | 16.67% | 6.25% |
| Shëndeti dhe mirëqenia | 11.11% | 9.52% | 8.33% | 7.14% | 6.67% | 6.67% | 6.25% |
| Jeta dhe puna | 5.56% | 4.76% | 4.17% | 7.14% | 6.67% | 6.67% | 46.88% |
| Pjesa zgjedhore | 5.56% | 4.76% | 8.33% | 7.14% | 10% | 13.33% | 6.25% |
| Aktivitetet e tjera | | | | | | | |

Nga alokimi i fondit të orëve shohim se, që nga klasa parafillore e deri në përfundim të shkallës së katërt të Kurrikulës (klasa e nëntë), të gjithë nxënësit do të marrin një edukim të balancuar dhe të njësuar, i cili do të matet nëpërmjet testit të standardizuar shtetëror.

Prej shkallës së pestë, nxënësit do të kenë mundësinë e zgjedhjes së shkollimit të përgjithshëm (gjimnazet) apo shkollimit profesional. Për shkak të natyrës specifike të shkollave profesionale (përveç të tjerash, edhe shkollat e muzikës, të artit etj.), alokimi i fondit të orëve ndryshon dukshëm për fushat e ndryshme të Kurrikulës në këto dy shkallë. Me Kurrikulën Bërthamë të shkollave të mesme të larta, do të përcaktohen rezultatet esenciale të të nxënit të përbashkët për të gjithë nxënësit që përfundojnë shkallën VI (nxënësit e gjimnazeve dhe të shkollave profesionale), për të kaluar testin e maturës.

Si Kurrikula Bërthamë, ashtu edhe ajo me bazë shkolle kanë një të përbashkët, se të dyja duhet të ndihmojnë nxënësit në arritjen e kompetencave kryesore të përcaktuara me këtë Kornizë. Shkolla do të ofrojë këshillim në zgjedhjen e nxënësve, duke ndihmuar ata që të kenë përfitime nga mësimi zgjedhor, do të analizojë mundësitë e veta (kuadrin mësimor, kushtet e tjera, nevojat e komunitetit etj.) e pastaj do të marrë vendimin për kurrikulë me bazë shkolle. Pasi të definohet zgjedhja, ajo bëhet e obligueshme për të gjithë nxënësit e shkollës, monitorohet dhe vlerësohet me kriteret e njëjta, si pjesa tjetër e Kurrikulës. Vendimi për kurrikulën me bazë shkolle (10%-20% të totalit të kohës së shkollës), do të marrë parasysh disa opsione, nëpërmjet të cilave pjesa zgjedhore e Kurrikulës mund të përkufizohet si:

Aktivitete mësimore shtesë, që mund të ndihmojnë arritjen e kompetencave të caktuara (d.m.th. gjuha e shumicës, lëndët zgjedhore, punët në projekte, shërbimi në bashkësi, aktivitetet sportive dhe artistike);

- Aktivitete plotësuese për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë të ndonjë lënde të caktuar;
- Përforcim i dijes, i shkathtësive dhe i qëndrimeve në fusha të caktuara;
- Zgjedhje nga një listë me tema/kurse/module kurrikulare të parapërgatitur dhe të ofruara nga MASHT-i;
- Zhvillim i aktiviteteve të veçanta në shkollë nëpërmjet ndonjë projekti shkollor (siç janë mësimi i gjuhëve; i TIK-ut; orientimi në karrierë);
- Zhvillim dhe zbatim i kurrikulave specifike që u përshtaten kushteve, burimeve dhe nevojave të rajonit ku ndodhet shkolla;

Përforcim i orientimit në karrierë dhe përgatitje për jetë dhe punë.

Pika e fundit vlen sidomos për shkollat e mesme të larta: gjimnazet dhe shkollat profesionale. Te shkollat profesionale plotësisht i dedikohet profilit profesional të cilin e ndjekin nxënësit. Ndërsa te gjimnazet, ka mundësi të përforcohet përgatitja e nxënësve për punë dhe për studime postsekondare.

### Llojet e gjimnazeve

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë do të ketë tri lloje të gjimnazeve:

1. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore
2. Gjimnazi i shkencave natyrore
3. Gjimnazi i specializuar (artistik, matematikor, gjuhësor, teknik etj.)

Shkollat profesionale do të përfitojnë nga pjesa zgjedhore e orëve, duke ia dedikuar fondin prej 10% të orëve arsimit profesional. Ky fond, së bashku me 50% të fushës Jeta dhe puna, do të përbëjnë afër 60% të kohës së mësimit të profesionit. Ndërkaq, përqindja e kohës së mbetur është dedikuar për fushat e tjera kurrikulare, të cilat do të jenë të zbatuara në profesion sa më shumë që është e mundur.

### Shkollat profesionale

1. Shkolla bujqësore
2. Shkolla teknike (elektroteknikë, makineri, ndërtimtari, grafikë, komunikacion, kimi teknologji)
3. Shkolla mjekësore
4. Shkolla ekonomi dhe administratë
5. Shkolla artistike

## 5.3. Autonomia e shkollës për zhvillimin e pjesës zgjedhore të Kurrikulës

Përcaktimi për pjesën zgjedhore të Kurrikulës i mundëson shkollës një autonomi të caktuar. Kjo pjesë duhet të kontribuojë në arritjen e kompetencave kryesore të përcaktuara

në këtë Kornizë. Për këtë pjesë shkollat duhet të vendosin në bashkëpunim me nxënësit, prindërit dhe palët e tjera. Shkolla duhet të hartojë programe fleksibile dhe inovative për këtë pjesë të Kurrikulës në përputhje me nevojat, kontekstet dhe interesat e nxënësve dhe të komunitetit të caktuar.

Pasi shkolla merr iniciativën lidhur me shfrytëzimin e pjesës zgjedhore, ajo parashtron propozimin te DKA-ja dhe te MASHT-i për miratim final të programit të propozuar. Kjo pjesë e Kurrikulës monitorohet, vlerësohet dhe evidentohet me kritere dhe parime të njëjta si të gjitha fushat e tjera të Kurrikulës.

MASHT-i mund të ofrojë edhe propozime të planeve mësimore të cilat mund ta orientojnë shkollën. Shpërndarja e fondit të orëve sipas lëndëve dhe klasave për pjesën zgjedhore të Kurrikulës do të jetë në kuadër të autonomisë së shkollës. Kjo i mundëson shkollës që të organizojë kuadrin mësimor në dispozicion me specifikat e komunitetit ku vepron shkolla. Planet mësimore për pjesën zgjedhore të Kurrikulës të hartuara nga shkollat do të kenë mbështetjen e shërbimeve pedagogjike nga niveli qendror e lokal. Të gjitha këto plane dhe programe mësimore do të marrin miratimin e përgjegjësve të arsimit në nivelin lokal dhe qendror para fillimit të zbatimit të tyre.

# 6. Dokumentet e Kurrikulës: çka pritet nga shkollat dhe nga mësimdhënësit?

Dokumente të Kurrikulës, që e mundësojnë zbatimin e saj në nivel të sistemit arsimor, duke përcaktuar qartë pritshmërinë nga mësimdhënësit dhe shkollat, të cilat duhet të zhvillohen:

- ❑ Kurrikula e fëmijërisë së hershme (lindje - 5 vjeç),
- ❑ Kurrikula Bërthamë për arsimin fillor, të mesëm të ulët, gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ❑ Planet dhe programet lëndore nga klasa parafillore deri në kl. XII, duke mbuluar të gjitha fushat /lëndët mësimore për secilën klasë.

Dokumentet e tjera, të cilat mundësojnë zbatimin e Kurrikulës në nivel shkolle përfshijnë tekstet shkollore, materialet plotësuese të mësimdhënies dhe nxënies, si dhe materialet didaktike e instrumentet për vlerësim.

## 6.1. Hierarkia e dokumenteve të Kurrikulës së Kosovës

<table>
<tr><td colspan="18">KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS</td></tr>
<tr><td colspan="2">Kurrikula e fëmijërisë së hershme</td><td colspan="6">Kurrikula Bërthamë (KB) për arsimin fillor</td><td colspan="4">KB për Arsimin e Mesëm të Ulët</td><td colspan="6">KB për Arsimin e Mesëm të Lartë[3]</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Lindje -3 vjeç</td><td rowspan="3">3-5 vjeç</td><td colspan="3" rowspan="2">KB për ShK1</td><td colspan="3" rowspan="2">KB për ShK2</td><td colspan="2" rowspan="2">KB për ShK3</td><td colspan="2" rowspan="2">KB për ShK4</td><td colspan="4">KB për Shk5</td><td colspan="2">KB për Shk6</td></tr>
<tr><td colspan="2">Kurrikula e gjimnazeve</td><td colspan="2">Kurrikula e AAP</td><td>Kurrikula e gjimnazeve</td><td>Kurrikula e AAP</td></tr>
<tr><td>Pp[4] kl. pf</td><td>Pp kl. I</td><td>Pp kl. II</td><td>Pp kl. III</td><td>Pp kl. IV</td><td>Pp kl. V</td><td>Pp kl. VI</td><td>Pp kl. VII</td><td>Pp kl. VIII</td><td>Pp kl. IX</td><td>Pp kl. X</td><td>Pp kl. XI</td><td>Pp kl. X</td><td>Pp kl. XI</td><td>Pp kl. XII</td><td>Pp kl. XII</td></tr>
<tr><td colspan="18">TEKSTET SHKOLLORE</td></tr>
<tr><td colspan="18">MATERIALE PLOTËSUESE TË MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES</td></tr>
<tr><td colspan="18">INSTRUMENTET PËR VLERËSIM TË NXËNËSVE</td></tr>
</table>

## 6.2. Kurrikula Bërthamë

Kurrikula Bërthamë paraqet dokumentin themelor të Kurrikulës për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, dispozitat e së cilës vendosen nga MASHT-i dhe janë obliguese për të gjithë nxënësit e Republikës së Kosovës.

Sistemi i Rezultateve të të Nxënit (RN)  në kuadër të Kurrikulës Bërthamë përcakton:

- Rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të Kurrikulës me rastin e përfundimit të secilës nga gjashtë shkallët e Kurrikulës,
- Rezultatet e të Nxënit sipas fushave të Kurrikulës për secilën fushë të Kurrikulës gjatë një shkalle të Kurrikulës.

Derisa Rezultatet e të Nxënit sipas fushave të Kurrikulës mundësojnë integrimin dhe qasjen e tërësishme në mësimdhënien e lëndëve të veçanta brenda një fushe të Kurrikulës, Rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të Kurrikulës promovojnë integrim të mëtejmë të fushave të Kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës. Ato shprehin pritjet e mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve në fund të çdo shkalle  të  Kurrikulës.

3 Kurrikula e Arsimit të Mesëm të Lartë përcakton kërkesat e përbashkëta që duhet t'i arrijnë të gjithë nxënësit e përfshirë në këtë nivel përgjatë shkallës V dhe VI të Kurrikulës. Kurrikulat specifike për gjimnaze dhe për shkolla profesionale përcaktojnë Rezultatet e të Nxënit në kuadër të fushave kurrikulare.

4 Pp është shkurtesë për planet dhe programet.

## Rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të Kurrikulës

Rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të Kurrikulës, që parashihen të përvetësohen nga të gjithë nxënësit me rastin e përfundimit të një shkalle të Kurrikulës, nuk mbulojnë gjithçka që nxënësit kanë mësuar apo është dashur të mësojnë gjatë një shkalle të caktuar. Ato shprehin kërkesat esenciale të arritshmërisë drejt zotërimit të kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të një shkalle të caktuar të Kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të Kurrikulës paraqesin një pasqyrë të qartë të asaj që nxënësit domosdoshmërisht duhet të dinë, të jenë në gjendje të shprehin dhe të bëjnë pas përfundimit të një shkalle të Kurrikulës dhe paraqesin kushtin për kalimin nga një nivel i shkollimit në tjetrin.

Kurrikula Bërthamë për shkollat e mesme të larta përcakton rezultatet e esenciale të të nxënit, të përbashkëta për të gjithë nxënësit të cilët vijojnë nivelin e mesëm të lartë. Rezultatet e të nxënit sipas fushave të Kurrikulës për gjimnaze dhe për shkolla profesionale do të përcaktohen në bazë të specifikave të këtyre dy nënsektorëve të arsimit të mesëm të lartë.

## Rezultatet e të Nxënit sipas fushave të Kurrikulës

Rezultatet e të Nxënit sipas fushave të Kurrikulës kanë funksion arsimor dhe pedagogjik, pasi ato synojnë të:

- ❑ Sigurojnë lidhshmërinë ndërmjet lëndëve dhe aktiviteteve mësimore, që realizohen në kuadër të një fushe të Kurrikulës me qëllim të integrimit të njohurive përkatëse (deklarative dhe procedurale), shkathtësive dhe qëndrimeve të ofruara përmes atyre lëndëve dhe, në përgjithësi, inkurajimin e mësimit të integruar;
- ❑ Promovojnë qasjen e bazuar në kompetenca, duke mundësuar zhvillim të një sistemi të përbashkët të përvojave mësimore të ndërlidhura, që u ofrohen nxënësve me qëllim të zhvillimit të “kompetencave kryesore për shekullin XXI”, siç janë përcaktuar nga KKK-ja;
- ❑ Sigurojnë një platformë për zhvillimin e planeve dhe programeve lëndore;
- ❑ Mundësojnë zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel shkolle, duke inkurajuar zhvillimin e planeve dhe programeve në bazë shkolle.

## Komponentët e tjerë të Kurrikulës Bërthamë

Aspekte të tjera që rregullohen me Kurrikulën Bërthamë përfshijnë:

- ❑ Fushëveprimin e fushave të Kurrikulës nëpër shkallë të Kurrikulës;
- ❑ Udhëzimet metodike për organizimin e procesit edukativ-arsimor në kuadër të secilës fushë të Kurrikulës gjatë shkallëve të Kurrikulës;
- ❑ Planet mësimore që përcaktojnë shpërndarjen e fondit të orëve për fushat e Kurrikulës gjatë shkallëve të Kurrikulës;
- ❑ Kërkesat për përparim gjatë niveleve formale të arsimit, përfshirë pragun e kalueshmërisë nga një shkallë e Kurrikulës në tjetrën;
- ❑ Kriteret dhe format e vlerësimit dhe
- ❑ Rekomandimet për menaxhimin e Kurrikulës në nivel shkolle.

## 6.3. Planet dhe programet sipas lëndëve

Planet dhe programet lëndore do të përgatiten në nivel shkolle[5] në harmoni me dispozitat e përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë. Sistemi i rezultateve të të nxënit në kuadër të planeve dhe programeve lëndore përcakton nivelin e dijeve dhe aftësive/shkathtësive, që nxënësit duhet t'i arrijnë në kuadër të secilës lëndë dhe njësi tematike/mësimore përgjatë një klase/viti shkollor.

Krahas RN-ve, planet e programet lëndore do të përmbajnë edhe:

- ❑ Njësitë tematike/mësimore të lëndëve përkatëse për secilën klasë;
- ❑ Udhëzimet metodike për realizimin e njësive tematike/mësimore në kuadër të lëndës përkatëse;
- ❑ Mundësitë e organizimit të përvojave mësimore gjatë një viti shkollor, përfshirë planet mësimore që përcaktojnë shpërndarjen e fondit të orëve sipas lëndëve për secilën klasë;
- ❑ Materialet didaktike dhe burimet e mjetet ndihmëse.

Të gjitha dokumentet e Kurrikulës duhet të hartohen në përputhje me parimet themelore të KKK-së duke mundësuar:

- ❑ Përzgjedhjen e përmbajtjeve që kanë për bazë përvojat paraprake të nxënësve, interesat dhe mundësitë e tyre;
- ❑ Organizimin e aktiviteteve mësimore, që janë sfiduese dhe atraktive për nxënësit;
- ❑ Organizimin e aktiviteteve mësimore, që marrin parasysh dallimet ndërmjet nxënësve (që kanë të bëjnë me stilet e ndryshme të të mësuarit dhe të gjitha aspektet e tjera të diversitetit, siç janë: çështjet gjinore, mosha, etnia, religjioni, kultura, prejardhja shoqërore dhe ekonomike, si dhe nevojat e veçanta të nxënësve);
- ❑ Zhvillimin e kompetencave për nxënie të vazhdueshme për jetë dhe punë;
- ❑ Mësimin gjithëpërfshirës dhe të plotë që integron dhe reflekton lidhjet dhe ndërvarësitë në botë;
- ❑ Ndërlidhjen ndërmjet aspektit konceptual dhe dimensioneve praktike, si: zbatimi i dijes dhe shfrytëzimi i shkathtësive të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale;
- ❑ Integrimin e fushave të reja kurrikulare që reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore apo të shkencës (si teknologjia e komunikimit dhe informimit, mësimi elektronik, vetëdijesimi mbi mediet, shkathtësitë jetësore);

5 Duke pasur në parasysh nivelin aktual të përgatitjes së mësimdhënësve, MAShT-i, në kuadër të procesit të gjithëmbarshëm të reformës së Kurrikulës, do të fasilitojë punën e shkollave për hartimin e planeve e programeve të reja me bazë në shkollë për të gjitha lëndët. Procesi i hartimit të planeve e programeve të reja do të fillojë pas një rishikimi të hollësishëm cilësor të planeve e programeve ekzistuese, i cili do t'i përfshijë mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe komunitetin në të cilin vepron shkolla. Udhëzimet e detajuara dhe instrumentet e nevojshme për rishikimin e planeve e programeve do të përgatiten menjëherë pas hartimit të Kurrikulave Bërthamë, ndërsa hartimi i planeve e programeve të reja do të fillojë vetëm pas një analize të hollësishme të informatave kthyese mbi vlerësimin e nevojave për ndryshim.

- ❑ Perspektivën e mësimit tërëjetësor, me theks të posaçëm në kompetencat për të nxënë, për përdorimin e teknologjive të reja dhe kompetencat për vlerësimin dhe përpunimin e informacioneve në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme.

# 7. Sistemi i vlerësimit të nxënësve

Gjatë këtij procesi vlerësohet progresi i vazhdueshëm dhe niveli i arritjes së rezultateve të të nxënit të përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë dhe planet e programet lëndore.

Sistemi i rezultateve të të nxënit, të përcaktuara me sistemin e Kurrikulës së Republikës së Kosovës, është paraqitur në vijim.

| Hierarkia e dokumenteve të Kurrikulës | Sistemi i rezultateve të të nxënit |
|---|---|
| KORNIZA E KURRRIKULËS E KOSOVËS | Rezultatet kryesore të të nxënit që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritjes së kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të arsimit parauniversitar. |
| KURRIKULA BËRTHAMË PËR SHKALLËT E KURRIKULËS 1-6 | Rezultatet e të nxënit që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritjes së kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të çdo shkalle të Kurrikulës. |
| | Rezultatet e të nxënit për secilën fushë të Kurrikulës gjatë një shkalle të Kurrikulës. |
| PLANET E PROGRAMET LËNDORE | Rezultatet e të nxënit sipas lëndëve, për secilën klasë. |

## 7.1. Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm duhet t'u mundësojë të gjithë nxënësve të shprehin nivelin e zotërimit të dijeve, zhvillimit të shkathtësive dhe formimit të qëndrimeve të tyre me anë të detyrave dhe kërkesave që kanë nivele të ndryshme të kompleksitetit, përfshirë:

- ❑ Gjerësinë dhe thellësinë e të nxënit të përvetësuar;
- ❑ Gatishmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënit dhe për të ecur drejt të nxënit edhe më sfidues;
- ❑ Aftësinë për të zbatuar të nxënit në situata dhe rrethana të reja.

Zbatimi i vlerësimit bazuar në kompetencat e përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës, do t'u mundësojë mësimdhënësve dhe shkollës që të jenë të saktë dhe të besueshëm në vlerësimin e arritjeve të nxënësve në të gjitha shkallët e shkollimit të tyre.

## Vlerësimi i nxënësve në nivel klase

Qëllimet e vlerësimit të nxënësve në nivel klase janë si vijon:

- ❑ Planifikimi i punës së mëtejme me nxënës;
- ❑ Vlerësimi i arritjes së nxënësve;
- ❑ Identifikimi i prirjeve dhe talentit të nxënësve.

Vlerësimi në nivel klase përfshin vlerësimin e vazhdueshëm gjatë gjithë vitit shkollor, vlerësimin përfundimtar (me rastin e përfundimit të vitit shkollor) dhe vlerësimin përmbyllës (me rastin e përfundimit të shkallës së Kurrikulës).

Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve, përveç formave të ndryshme joformale gjatë gjithë procesit mësimor, bëhet përmes shkallës së vlerësimit që përfshin notat nga 1- 5.

- ❑ **Nota 1:** performancë e e pamjaftueshme në realizimin e detyrës së dhënë;
- ❑ **Nota 2:** performancë e mjaftueshme në realizimin e detyrës së dhënë;
- ❑ **Nota 3:** performancë e mirë në realizimin e detyrës së dhënë;
- ❑ **Nota 4:** performancë e shumë mirë dhe e kompletuar në realizimin e detyrës së dhënë;
- ❑ **Nota 5:** performancë e shkëlqyeshme dhe origjinale në realizimin e detyrës së dhënë.

Kjo shkallë vlerësimi përdoret për të vlerësuar çdo situatë në të cilën nxënësi sfidohet për të realizuar një detyrë të caktuar nga mësimdhënësi dhe evidentohet në ditar apo/dhe në regjistrat përkatës të mësimdhënësit/shkollës. Referencë kryesore për vlerësimin për nxënie dhe për llojet e tjera të vlerësimit janë rezultatet specifike të të nxënit, të përcaktuara në kuadër të planeve e programeve shkollore (shih rezultatet e të nxënit sipas lëndëve dhe njësive tematike në tabelën e sistemit të rezultateve të të nxënit).

1. Vlerësimi përfundimtar bëhet në fund të çdo viti shkollor dhe reflekton nivelin e performancës së nxënësit gjatë një viti shkollor[6].

Përshkrimi i shkallës së vlerësimit përfundimtar me notë është si vijon:

- ❑ Nota D: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivel të shkallës së vlerësimit 2 (2.00 – 2.49).
- ❑ Nota C: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivel të shkallës së vlerësimit 3 (2.50 – 3.49).

6 Udhëzime të detajuara në lidhje me mënyrën e organizimit të vlerësimeve përfundimtare jepen në kuadër të Kurrikulës Bërthamë për nivelin përkatës.

- Nota B: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivel të shkallës së vlerësimit 4 (3.50 - 4.49).
- Nota A: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivel të shkallës së vlerësimit 5 (4.50 – 5.00).

Në fund të vitit shkollor, i cili shënon edhe përfundimin e një shkalle të Kurrikulës (klasa II, V, VII, IX, XI dhe XII), përveç vlerësimit përfundimtar, bëhet edhe vlerësimi përmbyllës.

2. Me rastin e vlerësimit përmbyllës nuk nxirret mesatarja aritmetike nga notat e regjistruara në ditar gjatë periudhës që mbulohet me shkallën përkatëse të Kurrikulës, por vlerësimi i nxënësit bëhet në bazë të listës së rezultateve të të nxënit për fushat kurrikulare të përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë (shih rezultatet e të nxënit sipas fushave kurrikulare në tabelën e sistemit të rezultateve të të nxënit).

Me këtë rast, për secilin nxënës evidentohet niveli i arritjes së çdo rezultati të paraparë të të nxënit në kuadër të një fushe kurrikulare[7]. Vlerësimi i arritjes për secilin rezultat bëhet në bazë të shkallës së vlerësimit 1-5. Ky vlerësim bëhet nga autoritetet komunale apo shkolla (ekipi i mësimdhënësve të cilët kanë mbuluar aspekte të ndryshme të fushës përkatëse kurrikulare)[8]. Nota përmbyllëse për fushën përkatëse me rastin e përfundimit të një shkalle të Kurrikulës (nota përfundimtare A, B, C dhe D) nxirret nga mesatarja aritmetike e vlerësimit të arritjes së rezultateve të të nxënit.

Nxënësit që kanë arritur nivelin A, B, C dhe D vazhdojnë në klasën/shkallën vijuese.

Nxënësit që kanë arritur nivelin D vazhdojnë në klasën/shkallën vijuese me programe shtesë në fushat/lëndët/modulet në të cilat performanca e tyre ka qenë nën shkallën e vlerësimit 2. Ata të cilët edhe me këtë rast nuk e arrijnë nivelin D përsërisin vitin shkollor.

Në librezën e nxënësit dhe në diplomën që lëshohet me rastin e përfundimit të një niveli të shkollimit regjistrohen vetëm notat përmbyllëse dhe rezultatet e vlerësimeve të standardizuara.

### Vlerësimi në nivel shkolle

Vlerësimi në nivel shkolle i referohet nivelit të arritjes së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore, të shprehura në kuadër të Kurrikulës Bërthamë, përmes rezultateve esenciale të të nxënit me rastin e përfundimit të çdo shkalle të Kurrikulës.

Rezultati i arritur evidentohet në librezën shkollore të nxënësit dhe po ashtu në dëftesën e lëshuar në fund të nivelit formal.

Ky vlerësim organizohet nga autoritetet komunale apo nga shkolla me qëllim të vetëvlerësimit të cilësisë së procesit edukativo-arsimor që ofrohet në nivel të shkollës si dhe me qëllim të planifikimit të masave për të siguruar nivelin e domosdoshëm të zotërimit të kompetencave kryesore nga të gjithë nxënësit.

7 Format përkatëse për vlerësimin e rezultateve të të nxënit për secilën fushë kurrikulare me rastin e përfundimit të një shkallë të Kurrikulës do të jepen në kuadër të Kurrikulës Bërthamë.
8 Udhëzime të detajuara në lidhje me mënyrën e organizimit të vlerësimeve përmbyllëse ofrohen në kuadër të Kurrikulës Bërthamë për nivelin përkatës.

Vlerësimi i arritjes së rezultateve esenciale të të nxënit (shih rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të Kurrikulës në tabelën e sistemit të rezultateve të të nxënit) bëhet për secilin nxënës nga ekipi i mësimdhënësve që kanë punuar gjatë periudhës që mbulohet me vlerësim[9]. Të dhënat e përpunuara në nivel shkolle, përfshirë edhe masat e planifikuara për modalitetet e punës plotësuese me nxënës dorëzohen tek autoriteti komunal i arsimit.

## 7.2. Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i jashtëm i arritjes së nxënësve organizohet nga autoritetet qendrore të arsimit me qëllim të verifikimit të gjendjes dhe nivelit të cilësisë së arsimit dhe vlerësimit në nivel shkolle, komune apo shteti.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet me qëllim:

- ❑ Inspektimi dhe verifikimi të cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle apo komune;
- ❑ Vlerësimi të standardizuar në nivel shtetëror;
- ❑ Hulumtimi;
- ❑ Përdorimi të rezultateve.

Vlerësimet e standardizuara shtetërore organizohen me rastin e përfundimit të klasës V, IX dhe klasës XII. Vlerësimet shtetërore janë të përqendruara në matjen e nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kryesore.

Vlerësimi shtetëror i klasës V i referohet nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kryesore të shprehura në Kurrikulën Bërthamë, përmes rezultateve të të nxënit në shkallët kurrikulare. Ky vlerësim u shërben autoriteteve qendrore dhe komunale për të parë arritjet e nxënësve.

Vlerësimi i standardizuar në fund të klasës IX i referohet nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kryesore të shprehura në Kurrikulën Bërthamë përmes rezultateve të të nxënit në shkallët kurrikulare. Ky vlerësim vendos edhe kriteret e qarta për nivelin e domosdoshëm të arritjes për t'u orientuar në nivelin vijues të arsimit, në shkollën e mesme të lartë.

Vlerësimi i standardizuar në fund të klasës XII, Provimi i Maturës Shtetërore, synon matjen e nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kryesore të shprehura përmes rezultateve të të nxënit në shkallët kurrikulare dhe përmes rezultateve kryesore të të nxënit në Kornizën e Kurrikulës të Kosovës. Ky vlerësim vendos edhe kriteret e qarta për:

(a) nivelin e domosdoshëm të arritjes për marrjen e diplomës së shkollës së mesme të lartë dhe

(b) nivelin e nevojshëm të arritjes për regjistrim në Universitet.

9 Format përkatëse për vlerësimin e arritjes së kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të një shkalle të Kurrikulës do të jepen në kuadër të Kurrikulës Bërthamë.

Nxënësit të cilët e përfundojnë me sukses Provimin e Maturës Shtetërore, pajisen me dokumentin Diplomë e Maturës Shtetërore.

Nxënësit që përfundojnë klasën XII në shkollat profesionale po ashtu i nënshtrohen Provimit të Maturës[10], në mënyrë që edhe për ta të konstatohet niveli i arritjes në zotërimin e kompetencave kryesore.

Përveç Provimit të Maturës Shtetërore, nxënësit e shkollave profesionale do të zotërojnë edhe kompetencat që i parasheh profesioni i caktuar, prandaj në fund të klasës XII në shkollat profesionale mbahet edhe Provimi Përfundimtar i profesionit. Ky është provim gjysmë i jashtëm, i cili administrohet nga shkollat dhe autoritetet komunale të arsimit. Bazuar në rezultatet e këtij provimi nxënësit kualifikohen për profesion përkatës (niveli IV i Kornizës Kombëtare të Kualifikimit) dhe me këtë kualifikim kanë mundësi:

(1) të hyjnë në tregun e punës, ose

(2) të vazhdojnë arsimin postsekondar jouniversitar në shkollat e larta profesionale(SNKA 4).

Kualifikimet (kompetencat) që janë arritur në forma të ndryshme të arsimit joformal dhe informal do të njihen në sistemin formal të arsimit mbi bazë të procedurave të njohjes dhe akreditimit, të përcaktuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit.

| **Hierarkia e dokumenteve të Kurrikulës** | **Llojet e rezultateve të të nxënit** | **Lloji i vlerësimit** |
|---|---|---|
| KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS | Rezultatet kryesore të të nxënit, që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritjes së kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të arsimit parauniversitar | Vlerësimi shtetëror me rastin e përfundimit të shkollës së mesme të lartë<br>“Diploma e Maturës Shtetërore” |
| KURRIKULA BËRTHAMË PËR SHKALLËT E KURRIKULËS I-VI | Rezultatet esenciale të të nxënit, që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritjes së kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të çdo shkalle të Kurrikulës | Vlerësimi në nivel shkolle<br><br>“Dëftesa shkollore”<br>“Diploma e profesionit”[11] |
| | Rezultatet e të nxënit sipas fushave të Kurrikulës, për secilën shkallë të Kurrikulës | Vlerësimi përmbyllës në nivel klase<br>“Libreza shkollore e nxënësit” |
| PLANET E PROGRAMET LËNDORE | Rezultatet e të nxënit sipas lëndëve, për secilën klasë | Vlerësimi përfundimtar<br>“Certifikatë e notave”<br>Vlerësimi i vazhdueshëm formativ<br>”Portofolio e nxënësit” |

10 Kriteret se kush i nënshtrohet Provimit të Maturës përcaktohen në një udhëzim administrativ.
11 Në shkollat profesionale, në përfundim të shkollimit, nxënësit marrin edhe diplomën e profesionit, të paraparë me Kornizën e Kurrikulës së arsimit profesional.

# 2

# ZBATIMI I KORNIZËS SË KURRIKULËS

# 1. Roli i shkollës: sigurimi i një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e kompetencave

Kurrikula siguron autonomi të shtuar në nivel shkolle për të planifikuar dhe për të vepruar në zbatimin e Kurrikulës në përputhje me kushtet specifike të kuadrit mësimor, infrastrukturës së shkollës dhe specifikave të lokalitetit në të cilin vepron shkolla. Në këtë mënyrë secilës shkollë i mundësohet që të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve të saj dhe të lokalitetit në të cilin vepron.

Shkollat shqyrtojnë përparësitë dhe dobësitë e secilit mësimdhënës dhe në mënyrën më të mirë organizojnë procesin mësimor. Mësimdhënësit shfrytëzojnë fleksibilitetin e shtuar për planifikimin dhe shfrytëzimin e një game të gjerë të metodave mësimore të përshtatshme për qasje interaktive dhe të individualizuar punës me nxënës drejt arritjes së rezultateve të përcaktuara të të nxënit.

### Mundësitë dhe kërkesat e Kurrikulës

| Palët kryesore në procesin mësimor | Mundësitë e reja/ kërkesat e Kurrikulës |
|---|---|
| Nxënësi | Njihet me objektivat mësimore dhe rezultatet e pritura të të nxënit<br>Ndjek progresin e arritur, duke e krahasuar me nivelin e pritshmërisë dhe bën vetëvlerësim të vazhdueshëm<br>Është pjesë e vendimeve të rëndësishme për organizimin e punës në shkollë që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe me mbarëvajtjen e përgjithshme të punës në shkollë |
| Kuadri mësimor | Përdor një varg metodash, përshtatur kontekstit dhe nevojave, interesimeve dhe mundësive të nxënësve<br>Përzgjedh përmbajtje relevante për nxënësit dhe planifikon proces të integruar mësimor, duke marrë në konsideratë lidhjen mes lëndëve dhe fushave të Kurrikulës<br>Inkurajon nxënësit që të zgjerojnë horizontin e tyre dhe që të jenë më të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e ndryshme në jetë, në mësime dhe në punë<br>Përgjatë gjithë punës me nxënës kujdeset që të integrojë çështjet dhe përvojat mësimore të cilat kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kryesore<br>Merr pjesë në zhvillimin e planeve e programeve dhe materialeve mësimore të veçanta, e po ashtu edhe në përgatitjen e planeve fleksibile mësimore në pajtim me parimin e autonomisë së shkollës<br>Identifikon problemet, vështirësitë, por edhe afinitetet e nxënësve në të nxënë dhe siguron mbështetjen e individualizuar të nxënësve<br>Organizon mësim plotësues dhe shtues në bazë të vlerësimit të rezultateve të arritjes së nxënësve, përfundimtar (me rastin e përfundimit të vitit shkollor);<br>Aplikon vlerësimin për të nxënit me qëllim që t'u ofrojë nxënësve në mënyrë të vazhdueshme informata kthyese mbi progresin/ngecjet si dhe udhëzime, motivim dhe mbështetje për punë të mëtejme<br>Komunikon me prindërit për të siguruar angazhimin e nevojshëm për nxitjen e përparimit të nxënësve<br>Angazhohet në punë ekipore dhe bashkëpunon me aktivin e profesional në planifikimin për këmbimin e përvojave në procesin e të nxënit, në vlerësimin e progresit të vazhdueshëm të nxënësve dhe të arritjeve në fund të shkallëve të Kurrikulës |

| | |
|---|---|
| Shërbimi profesional i shkollës (shërbimi pedagogjik, psikologjik, social etj.) | Mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme performancën e personelit edukativ, identifikon nevojat për përkrahje dhe siguron mbështetjen e nevojshme profesionale<br>Siguron bashkëpunimin e nevojshëm ndërmjet mësimdhënësve dhe planifikimin e përbashkët të përvojave të të nxënit<br>Këshillon personelin menaxhues të shkollës për planifikimin e angazhimit të mësimdhënësve<br>Identifikon nevojat për angazhimin e ekspertëve të jashtëm në shkollë<br>Identifikon mundësitë për shfrytëzimin e shërbimeve të tjera publike në funksion të realizimit sa më efektiv të Kurrikulës së re<br>Evidenton në mënyrë të vazhdueshme progresin e shkollës drejt zbatimit të Kurrikulës, sfidat dhe zgjidhjet e bëra në nivel shkolle<br>Organizon procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve me rastin e përfundimit të shkallëve të Kurrikulës dhe në bashkëpunim me personelin mësimor planifikon programet mbështetëse (mësimin plotësues dhe shtues) në nivel shkolle<br>Administron procesin e shkëmbimit të përvojave ndërmjet shkollave |
| Drejtori i shkollës | Siguron që shkolla të jetë një mjedis mësimor miqësor, i sigurt dhe i këndshëm për nxënësit<br>Siguron ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsimit në shkollë dhe llogaridhënies së mësimdhënësve<br>Siguron që kultura e përgjithshme e shkollës dhe atmosfera në klasë të kontribuojnë në kultivimin e vlerave dhe qëndrimeve të përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë<br>Siguron mundësitë për mësimdhënie të diferencuar si në kuadër të aktiviteteve kurrikulare ashtu edhe të atyre jashtëkurrikulare<br>Administron në mënyrë efektive fleksibilitetin dhe autonominë e shtuar për planifikimin dhe zbatimin e Kurrikulës në përputhje me kushtet specifike të personelit mësimor, infrastrukturës së shkollës dhe specifikave të lokalitetit në të cilin vepron shkolla<br>Punon, në bashkëpunim me palët e interesit, drejt zhvillimit të një koncepti të qartë për shkollën, përfshirë vizionin dhe misionin e shkollës e po ashtu edhe mënyrat se si parasheh shkolla të përmirësojë cilësinë, barazinë dhe llogaridhënien mbi cilësinë e shërbimeve arsimore<br>Angazhohet për shkëmbimin e përvojave të mira, përballimin e sfidave dhe për gjetjen e zgjidhjeve për problemet e evidentuara gjatë procesit të zbatimit të Kurrikulës<br>Mundëson bashkëpunimin e shkollës me shërbimet e tjera të fëmijëve në mënyrë që të përkrahen nxënësit për të kapërcyer vështirësitë në të nxënë dhe pengesat e nxënësve për vijimin e shkollës<br>Siguron respektimin e parimeve të demokracisë së shkollës, përfshirë nxënësit, prindërit dhe bartësit e tjerë të arsimit në vendimmarrjen në nivel të klasës dhe shkollës<br>Siguron që rregullat dhe procedurat e funksionimit të shkollës të jenë të qarta dhe transparente<br>Siguron respektimin e llogaridhënies ndaj palëve të interesuara, komunitetit dhe autoriteteve të arsimit |
| Këshilli i nxënësve | Reflekton mbi performancën e përgjithshme të shkollës dhe mësimdhënësve, mjedisin shkollor dhe çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve; trajton shqetësimet, kërkesat dhe rekomandimet e nxënësve me Këshillin Drejtues, drejtorin e shkollës dhe autoritetet lokale të arsimit |
| Këshilli i prindërve | Monitoron mjedisin shkollor si dhe performancën e përgjithshme të shkollës dhe të mësimdhënësve; trajton shqetësimet, kërkesat dhe rekomandimet e prindërve me Këshillin Drejtues dhe autoritetet lokale të arsimit |
| Këshilli drejtues | Miraton në nivel shkolle planet dhe programet e zhvilluara me bazë shkolle dhe i përcjell tutje për shqyrtim dhe miratim nga autoritetet arsimore<br>Shqyrton dhe miraton planet vjetore mësimore të përgatitura në nivel shkolle<br>Propozon aktivitetet jashtëkurrikulare<br>Shqyrton dhe miraton propozimet e shkollës për shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të Kurrikulës dhe aktivitetet jashtëkurrikulare<br>Shqyrton dhe miraton listën e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera<br>Ushtron funksione të ndërlidhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës<br>Zgjedh kuadrin arsimor, stafin menaxhues dhe stafin mbështetës të shkollës<br>Vendos rendin shtëpiak të shkollës |

Në kuadër të aktiviteteve përgatitore për zbatimin e Kurrikulës, të gjitha shkollat, para përfshirjes në procesin e zbatimit, definojnë misionin e shkollës dhe përgatisin planet trevjeçare zhvillimore të shkollës. Këto plane u dorëzohen drejtorive komunale të arsimit për miratim.

Planet fillestare zhvillimore të shkollave do të përfshijnë:

- Pasqyrën aktuale të situatës në shkollë në dritën e kërkesave të Kurrikulës, me fokus të veçantë në:
  - Infrastrukturën e shkollës
  - Kuadrin mësimor
  - Shërbimin profesional të shkollës
  - Kuadrin drejtues
  - Materialet didaktike

- Planifikimin e masave (planin trevjeçar të zhvillimit) për të siguruar ngritjen e kapacitetit të shkollës në nivelin e domosdoshëm për të përmbushur kërkesat e Kurrikulës.

## 2. Hartimi i materialeve të reja për mësimdhënie dhe nxënie në mbështetje të zhvillimit të kompetencave

Nga perspektiva e punës me nxënësin në qendër dhe e punës së bazuar në kompetenca, është e rëndësishme që burimet mësimore t'i motivojnë nxënësit dhe të stimulojnë progresin e tyre. Përderisa tekstet shkollore janë burime të vlefshme të të nxënit, qasja e nxënësve informacionit nuk kufizohet vetëm në tekstet shkollore. Qasja dhe përdorimi i një spektri më të gjerë të burimeve mësimore, për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë, do të evitojë të nxënit rutinor e memorizues dhe do të ofrojë mundësi të të mësuarit për të nxënë.

Mësimdhënësit shfrytëzojnë burime mësimore të cilat inkurajojnë dhe promovojnë përvetësimin e dijeve relevante, zhvillimin e shkathtësive, të vlerave dhe qëndrimeve të cilat shpien drejt zotërimit gradual të kompetencave kryesore. Pra, pavarësisht për cilin nivel të arritjes bëhet fjalë, kompetencat kryesore, REN të kurrikulës bërthamë, RN të fushave të Kurrikulës, apo RN të planeve e programeve lëndore / njësive të ndryshme tematike, mund të përdoren burime të shumta mësimore dhe jo vetëm një libër i caktuar, si për shembull:

- ❑ Tekste të lëndëve të ndryshme në kuadër të një fushe;
- ❑ Materiale të krijuara nga vetë mësimdhënësit për njësi të ndryshme tematike;
- ❑ Burime të gatshme nga faqe të ndryshme të internetit;
- ❑ Platforma e mësimit elektronik;
- ❑ Biblioteka elektronike;
- ❑ Burime të ndryshme nga jeta e përditshme (katalogë, udhëzues etj.).

Pavarësisht formatit dhe qëllimit (p.sh. softuerë arsimorë, pako eksperimentale apo tjetër), burimet mësimore duhet të hartohen në harmoni me parimet themelore të KKK-së, duke mundësuar:

- ❑ mësimdhënie dhe nxënie që në mënyrë të balancuar siguron përvetësimin e dijeve, zhvillimin e shkathtësive dhe qëndrimeve të larta intelektuale;
- ❑ zbatimin e metodave interaktive të mësimdhënies dhe të procedurave të vlerësimit, të cilat adresojnë shkathtësi të larta intelektuale, përfshirë kreativitetin dhe zgjidhjen e pavarur të problemeve;
- ❑ promovimin e vlerave pozitive, parimeve dhe përvojave, si: të drejtat e njeriut, drejtësia sociale dhe gjithëpërfshirja;
- ❑ shmangien e paragjykimeve dhe stereotipave, qëndrimeve diskriminuese, urrejtjes dhe dhunës;
- ❑ aktivitete relevante dhe të përshtatshme për vlerësim dhe vetëvlerësim, si dhe aktivitete të cilat përkrahin zhvillimin e kompetencës për të mësuar;
- ❑ ndërlidhjen me lëndët dhe fushat e tjera kurrikulare nëpër shkallë/nivele të Kurrikulës.

MASHT-i do të angazhohet për opsione financiarisht më të qëndrueshme për sigurim të teksteve mësimore dhe politika më të përshtatshme për konkurrencë mes botuesve dhe autorëve të librave shkollorë, për të hartuar materiale mësimore të cilësisë më të lartë sipas standardeve. Në këtë kontekst, sistemi dhe praktikat e botimit të librave shkollorë/teksteve mësimore, prokurimi dhe pajisja me libra shkollorë do të ndryshojnë dhe do t'u përshtaten kërkesave të Kurrikulës së re.

Shkollat dhe komunitetet inkurajohen të vendosin qendrat e burimeve mësimore, ku nxënësit mund të udhëzohen nga mësimdhënësit për identifikimin e burimeve të përshtatshme dhe shfrytëzimin e pavarur të tyre.

Mësimdhënësit shfrytëzojnë qendrat e burimeve mësimore për të pasuruar materialet dhe metodat e tyre mësimore.

Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit inkurajohen që të angazhohen në mënyrë aktive në hartimin e burimeve të përshtatshme mësimore në përputhshmëri me kërkesat mësimore dhe interesat e nxënësve[12]. Nxënësit, mësimdhënësit dhe bartësit e

12 Rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme. Mësimdhënësit mund të zhvillojnë dosje (portfolio, pako materialesh) për tema të ndryshme, duke shfrytëzuar gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës.

tjerë të arsimit bashkëpunojnë edhe në prodhimin e burimeve elektronike, për të nxënë përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Për nxënësit me vështirësi në të nxënë, përgatiten burime të përshtatshme dhe të individualizuara mësimore, sipas nevojave individuale të tyre.

# 3. Zbatimi i Kornizës së Kurrikulës për arsimin parauniversitar[13]

Për të vendosur një bazë të qëndrueshme të zbatimit të Kornizës së Kurrikulës duhet siguruar:

(a) hartimi i dokumenteve;

(b) përgatitja e plotë e sistemit shkollor dhe e shkollave individuale për të marrë përsipër zbatimin e Kurrikulës;

(c) ngritja e kapacitetit të kuadrit drejtues dhe mësimdhënës në shkolla për zbatimin e Kurrikulës, përfshirë zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

Korniza e Kurrikulës zbatohet në mënyrë graduale, përmes një pune të përbashkët të MASHT-it me drejtoritë komunale të arsimit, shkollat dhe partnerët e tjerë bashkëpunues.

Plani i zbatimit të Kornizës së Kurrikulës përfshin dy faza:

1. fazën përgatitore për zbatimin e Kornizës së Kurrikulës;
2. fazën e zbatimit të Kurrikulës.

Se është arritur zbatimi i plotë, do të konsiderohet vetëm kur:

- ❑ shkolla angazhohet vazhdimisht për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies drejt ngritjes së nivelit të arritjes së nxënësve;
- ❑ shkollat dhe drejtoritë komunale të arsimit angazhohen në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, sfidave dhe gjetjes së zgjidhjeve drejt përmbushjes së kërkesave të Kurrikulës;
- ❑ MAShT-i monitoron përmbushjen e kërkesave të Kurrikulës në nivel shtetëror, për rishikimin dhe plotësimin e politikave programore në fushën e arsimit dhe për sigurimin e mbështetjes institucionale;

13 Dinamika e detajizuar e zbatimit të Kornizës së Kurrikulës në kohë dhe faza të caktuara do të pasqyrohet në Planin e veprimit për zbatim, të miratuar në MASHT.

- MAShT-i harton normativin e mësimdhënësve dhe dokumentacionin pedagogjik;
- Infrastruktura shkollore përshtatet dhe riorganizohet për zbatim të standardeve me Kornizën e Kurrikulës.

## 3.1. Faza përgatitore për zbatimin e Kornizës së Kurrikulës

Faza përgatitore synon sigurimin e të gjitha parakushteve të domosdoshme për zbatimin e Kornizës së Kurrikulës të Kosovës, përfshirë:

**a.) hartimin dhe miratimin e pakos së plotë të dokumenteve të Kurrikulës;**

**b.) hartimin dhe miratimin e pakos së plotë të politikave nënsektoriale për zbatimin e Kurrikulës;**

**c.) përgatitjen e teksteve dhe materialeve të tjera shkollore;**

**d.) përgatitjen e dokumentacionit të ri pedagogjik;**

**e.) përgatitjen e komunave/shkollave prijëse për fazën e parë të zbatimit dhe**

**f.) zbatimin e Kurrikulës në shkollat prijëse.**

Faza përgatitore përfshin aktivitetet:

**g.) Zhvillimi i pakos së plotë të dokumenteve të Kurrikulës**

- Hartimi dhe publikimi i Kurrikulës Bërthamë të Kosovës për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (gjimnaze dhe shkolla profesionale);
- Hartimi, miratimi dhe publikimi i Kurrikulës për fëmijërinë e hershme;
- Hartimi dhe miratimi i planeve dhe programeve të reja, me bazë shkolle, në përputhje me kërkesat e Kurrikulës së re.

**h.) Hartimi dhe miratimi i pakos së plotë të politikave mbështetëse nënsektoriale për zbatimin e Kurrikulës:**

- Politikat dhe praktikat për zhvillim profesional të mësimdhënësve;
- Politikat dhe praktikat për zhvillim të shkollave, përfshirë standardet për infrastrukturën shkollore;
- Politikat dhe praktikat për zhvillim institucional të organeve në nivel qendror dhe lokal që merren me udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollave;
- Politikat dhe praktikat për krijimin e materialeve për mësimdhënie dhe nxënie (përfshirë edhe tekstet shkollore);
- Politikat dhe praktikat për vlerësimin e nxënësve.

**d.) Përgatitja dhe testimi i teksteve dhe materialeve të reja shkollore**

- ❑ Rishikimi i teksteve shkollore ekzistuese, duke iu referuar kërkesave të reja të Kurrikulës dhe standardeve të reja për tekstet shkollore;
- ❑ Hartimi i mostrave të reja të materialeve për mësimdhënie dhe të nxënit për përdorim në shkollat prijëse;
- ❑ Përgatitja e udhëzuesve për mësimdhënës mbi mundësitë e shfrytëzimit të teksteve ekzistuese në funksion të kërkesave të Kurrikulës së re dhe trajnimi i mësimdhënësve në shkollat prijëse për përdorimin e tyre.

**e.) Përgatitja e dokumentacionit të ri pedagogjik**

- ❑ Rishikimi dhe hartimi i dokumenteve të reja pedagogjike.

**f.) Përgatitja e komunave/shkollave prijëse për fazën e parë të zbatimit**

- ❑ Përgatitja e udhëzuesve/doracakëve për zbatimin e Kurrikulës për drejtoritë komunale të arsimit, kuadrin drejtues të shkollave, kuadrin mësimor dhe shërbimin profesional;
- ❑ Hartimi i planeve zhvillimore të shkollave prijëse dhe sigurimi i fondeve për zbatimin e tyre;
- ❑ Ngritja e kapacitetit të drejtorive komunale të arsimit mbi rolin e tyre në përmirësimin e nivelit të vijueshmërisë së shkollës, nivelit të arritjes së nxënësve si dhe drejt përmirësimit të shfrytëzimit efektiv të burimeve fizike, financiare dhe njerëzore në pajtim me mundësitë që ofron Kurrikula;
- ❑ Hartimi i Standardeve të Praktikës Profesionale të kuadrit drejtues të shkollave dhe ngritja e kapacitetit të kuadrit drejtues në shkollat prijëse mbi rolin e tyre dhe mundësitë e veprimit për si vijon:
  - sigurimin e një mjedisi miqësor dhe të sigurt për fëmijët;
  - ngritjen e cilësisë, barazisë dhe llogaridhënies së mësimdhënësve;
  - zhvillimin e një profili të qartë të shkollës së tyre, që reflekton karakteristikat e personelit të shkollës, infrastrukturës, komunitetit dhe mjedisit ku vepron, duke siguruar mundësi të diferencuara për zotërimin e kompetencave kryesore nga nxënësit;
  - respektimin e parimeve të demokracisë së shkollës, përfshirë nxënësit, prindërit dhe bartësit e tjerë të arsimit në vendimmarrje në nivel të klasës dhe shkollës;
  - ofrimin e qasjes së barabartë burimeve të informacionit dhe të nxënit për të gjithë nxënësit, duke respektuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit;
  - zbatimin e parimeve të arsimit gjithëpërfshirës duke respektuar diversitetin e nevojave dhe mundësive të nxënësve.

- ❑ Ngritja e kapacitetit të të gjithë kuadrit mësimor në shkollat prijëse mbi integrimin e qasjes me nxënësin dhe nxënien në qendër dhe qasjes që bazohet në kompetenca gjatë:

  (a) organizimit të përvojave mësimore të nxënësve,

  (b) vlerësimit të nivelit të arritjes së tyre dhe

  (c) përgatitjes, përzgjedhjes dhe shfrytëzimit të burimeve mësimore.

- ❑ Vendosja e shërbimeve profesionale;
- ❑ Fushata e informimit dhe konsultimit mbi ndryshimet që parasheh Kurrikula e arsimit parauniversitar me të gjitha palët e interesuara (nxënësit, prindërit, shoqëria civile, komuniteti i biznesit etj.).

### g.) Zbatimi i Kurrikulës në shkollat prijëse

Kurrikula do të zbatohet fillimisht në shkollat prijëse, të cilat do të përzgjidhen nga MAShT-i në konsultim me drejtoritë komunale të arsimit.

Kuadri mësimor dhe drejtuesit e shkollave prijëse përkrahen nga shërbimet profesionale të shkollave.

Faza e zbatimit në shkollat prijëse përfshin aktivitetet:

a) Zbatimin e Kurrikulës Bërthamë në disa shkolla të përzgjedhura duke u bazuar në:

- ❑ Politikat mbështetëse nënsektoriale dhe
- ❑ Udhëzimet për zbatim.

b) Sesione monitorimi, zhvillimi të vazhdueshëm profesional dhe trajnimi për DKA-të, personelin drejtues të shkollave dhe mësimdhënësit gjatë tërë procesit të zbatimit të Kurrikulës në komunat prijëse.

c) Krijim të rrjeteve për:

- ❑ shkëmbim të përvojave mes shkollave prijëse,
- ❑ bartje të përvojave të mira të shkollave prijëse në shkollat e tjera, si pjesë e përgatitjes për fazën vijuese,
- ❑ shkëmbim të përvojave ndërmjet DKA-ve dhe
- ❑ komunikim të vazhdueshëm të shkollave prijëse dhe DKA-ve me të gjitha palët e përfshira.

d) Hartimi i planprogrameve mësimore, duke u bazuar në Kurrikulën Bërthamë.

e) Hartimi gradual, botimi dhe shpërndarja e teksteve të reja shkollore dhe materialeve të tjera mësimore.

f) Përgatitja e të gjitha DKA-ve dhe shkollave për fazën e plotë të zbatimit:

- Ngritja dhe plotësimi i kuadrove profesionale për këshillim pedagogjik në nivel të komunës;
- Ngritja e kapacitetit të kuadrit drejtues të shkollave në mbarë Republikën e Kosovës;
- Përgatitja e planeve për zhvillimin e shkollave dhe sigurimi i fondeve për zbatimin e tyre;
- Ngritja e kapacitetit të personelit mësimor të shkollave në mbarë Republikën e Kosovës;
- Themelimi i shërbimeve profesionale në të gjitha shkollat;
- Zbatimi i masave të tjera të nevojshme për të siguruar gatishmërinë e shkollave për implementim.

Në fazën e pilotimit të zbatimit të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës në terren, nëse evidentohet ndonjë nga aspektet e KKK-së, që nuk mund të jetë funksional në praktikë, rekomandohet për ndryshim apo të revidohet më vonë.

## 3.2. Aplikimi gradual i pakos së plotë të Kurrikulës

Pakoja e plotë e Kurrikulës së Kosovës do të përbëhet nga:

- Planet e programet lëndore të hartuara për shkallë të Kurrikulës apo për klasë;
- Materialet përkatëse për mësimdhënie dhe nxënie (përfshirë tekstet shkollore ose lloje të tjera të materialeve, d.m.th. softuerë arsimorë, module mësimore etj.) për nxënësit.

Zhvillimin dhe zbatimin gradual të pakos së Kurrikulës mund ta paraqesim në formë të kësaj tabele.

| AKTIVITETET | Faza I | Faza II | Faza III | Faza IV | Faza V | Faza VI | Faza VII |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zhvillimi i planeve dhe programeve lëndore të hartuara për shkallë të Kurrikulës apo për klasë | Parafill.<br>Klasa VI<br>Klasa X | Klasa I<br>Klasa VII<br>Klasa XI | Klasa II<br>Klasa VIII<br>Klasa X | Klasa III<br>Klasa IX | Klasa IV | Klasa V | |
| Materialet përkatëse për mësimdhënie dhe nxënie | Parafill.<br>Klasa VI<br>Klasa X | Klasa I<br>Klasa VII<br>Klasa XI | Klasa II<br>Klasa VIII<br>KlasaXII | Klasa III<br>Klasa IX | Klasa IV | Klasa V | |
| Zbatimi i pakos së plotë | | Parafill.<br>Klasa VI<br>Klasa X | Klasa I<br>Klasa VII<br>Klasa XI | Klasa II<br>Klasa VIII<br>KlasaXII | Klasa III<br>Klasa IX | Klasa IV | Klasa V |

# Fjalorthi i Kornizës të Kurrikulës të Kosovës

| KONCEPTI | SHPJEGIMI | KONCEPTET EKUIVALENTE |
|---|---|---|
| Aftësitë për jetë | Aftësi që iu ofrojnë nxënësve kapacitete për të ndërmarrë detyra ose procese të ndërlidhura me jetën e tyre të përditshme. | |
| Aktivitetet ekstra-kurrikulare | Aktivitete të strukturuara mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve dhe fushave mësimore formale. Në disa sisteme, këto mund të përfshijnë përvojë pune apo sport të organizuar. | |
| Aktivitetet përmirësuese | Mundësi dhe përvoja mësimore që ofrohen me qëllim të sigurimit të ndihmës për nxënësit që të tejkalojnë vështirësitë në të nxënë në mënyrë efektive. | |
| Alokimi i kohes | Koha e caktuar për mësimdhënie dhe mësimin e një lënde të veçantë apo fushe mësimore gjatë një viti apo jave shkollore.Korniza e Kurrikulës siguron alokim të kohes për punë në projekte dhe mësimdhënie e mësimnxënie bashkëvepruese. | |
| Arsimi i detyrueshëm | Kohëzgjatja e shkollimit që konsiderohet si e obligueshme me ligj dhe (zakonisht) është falas për nxënësit dhe familjet e tyre. Përbërja e 'Arsimit të detyrueshëm' në Kosovë përfshin arsimin fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë (SNKA 1, 2 dhe 3). | |
| Arsimi dhe aftësimi profesional | Arsimi dhe aftësimi për t'iu mundësuar nxënësve që të fitojnë shkathtësi për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara, përveç arritjes së kompetencavekryesore të përcaktuara përmes Kornizës së Kurrikulës. | |
| Arsimi fillor | Në Kosovë, periudha ose cikli i parë i arsimit prej pesë vitesh kohëzgjatje, duke përfshirë edhe një klasë para-fillore (SNKA 1). | |

| | | |
|---|---|---|
| Arsimi formal | Sistem arsimor i strukturuar në mënyrë hierarkike dhe me klasë kronologjike që fillon me arsimin para-fillor deri në universitet duke përfshirë, përveç studimeve akademike të përgjithshme, një larmi të programeve të specializuara dhe institucioneve për aftësim teknik dhe profesional me orar të plotë. Rezultatet dhe kualifikimet e fituara në arsimin formal pranohen nga shoqëria përmes certifikatave dhe dhënies së diplomes. | |
| Arsimi gjithëpërfshirës | Arsimi gjithëpërfshirës tenton të adresojë nevojat për mësim të të gjithë fëmijëve me fokus të veçante tek ata që janë të cenueshëm ndaj margjinalizimit dhe përjashtimit. Ai nënkupton që të gjithë nxënësit – me ose pa paaftësi – janë në gjendje të mësojnë së bashku përmes qasjes në mjedise të përbashkëta parashkollore, shkolla dhe mjedise arsimore nëkomunitet me rrjet të përshtatshëm të shërbimeve përkrahëse. | |
| Arsimi informal | Përvetësimi dhe zhvillimi i dijes, shkathtësive dhe qëndrimeve jashtë mjediseve arsimore formale ose jo-formale gjatë përvojave të përditshme dhe në mungesë të procesit mësimor sistematik dhe të paraparë. | |
| Arsimi i mesëm | Faza apo cikli i dytë i shkollimit, e ndarë në dy faza - të ultë dhe të lartë (SNKA 2 dhe 3). | |
| Arsimi i mesëm i  ultë | Cikli i parë i arsimit të mesëm (katër vjeçar në  Kosovë) (SNKA 2). | |
| Arsimi jo-formal | Çfarëdo aktiviteti i organizuar dhe i qëndrueshëm që nuk korrespondon saktësisht me përkufizimin e arsimit formal. Prandaj arsimi jo-formal mund të mbahet edhe brenda edhe jashtë institucioneve arsimore dhe iu shërben personave të të gjitha moshave. Mund të përfshijë programe arsimore që adresojnë shkrim-leximin për të rritur, arsimin themelor për fëmijët që kanë braktisur shkollën, aftësitë për jetë, aftësitë për punë dhe kulturën e përgjithshme. Programet e arsimit jo-formal nuk përcjellin detyrimisht sistemin e ‘përshkallëzuar’ dhe mund të jenë të ndryshme në kohëzgjatje dhe mund të jipet ose të mos jipet certifikatë për suksesin e arritur në mësim. | |
| Arsimi i Përgjithshëm (shkollat) | Arritja dhe zhvillimi nga nxënësit më përgjithësisht i një game të gjerë të dijes, shkathtësive dhe qëndrimeve që janë të ndërlidhura me lëndet/mësimin akademik e poashtu edhe me jetën e punën. | |

| | | |
|---|---|---|
| Arsimi themelor | Vitet e shkollimit që konsiderohen si të nevojshme për të arritur standardet minimale për zotërimin e kompetencave kryesore | Zakonisht mbulon arsimin e detyrueshëm |
| Autonomia e shkollës | Autonomia e dhënë për shkolla në aspektin e menaxhimit të burimeve financiare (me financim publik dhe privat), menaxhimin e burimeve njerëzore (drejtorët e shkollave,personelin arsimor dhe jo-arsimor) dhe vendim-marrjes brenda shkollave e poashtu edhe sistemet e vlerësimit (llogaridhënia) e shkollave e realizuar në lidhje me këtëautonomi. | |
| Burimi i të mësuarit | Referenca dhe përkrahje për mësimin e nxënësve, përfshirë tekstet shkollore, softverët arsimorë, vegla eksperimentale, atllase, fjalorë, ushtrimore, etj. | |
| Çështjet të ndërlidhura | Përmbajte e rëndësishme kurrikulare që nuk i përket krejtësisht vetëm një lënde apo fushe të kurrikulës ekskluzivisht mësimore, por që më së miri mësohet në disa lëndë. Shembuj të zakonshëm janë edukimi për paqe, të drejtat e njeriut dhe edukata qytetare, çështjet gjinore, shkathtësitë e komunikimit, dhe edukimi ndërkulturor. | Temat të ndërlidhura |
| Dija | Konceptet dhe informatat faktike (të dhënat) e Po ashtu edhe relacionet mes tyre (p.sh. strukturat dhe modelet) lidhur me mjedisin natyror dhe artificial, njerëzit dhe shoqërinë, kulturën dhe ekonominë, dhe të kuptuarit tone për botën, njerëzit dhe shoqërinë. Dija deklatative vë në pah për të ditur lidhur me "çka", ndërsa dija procedurale vë në pah dijen lidhur me "si". | |
| Edukimi për ndërmarrësi | Në kuptimin e ngushtë: përgatitja e fëmijëve dhe të rinjve që të marrin role ndërmarrëse në ekonomi, d.m.th. të krijojnë bizneset/ndërmarrjet e tyre. Në kuptim më të gjerë: paisja e fëmijëve dhe të rinjve më shkathtësi ndërmarrëse siç janë iniciativa, vendim-marrja, ndërmarrja e riskut, udhëheqja, shkathtësi menaxheriale dhe organizative. | |
| Ekonomi dhe shoqëri e dijës | Shoqëri dhe ekonomi në të cilën dija bëhet burimi kryesori i zhvillimit dhe progresit (veçanërisht perms internetit, mësimit elektronik dhe proceseve të ndërmjetësuar nga paisjet elektronike). | |
| Edukimi shoku-shokun | Proceset e mësimit të bazuara në këmbimin e informatave, dijës dhe përvojave mes shokëve në të cilat ata veprojnë si persona burimorë lehtësuesë të mësimit dhe/ose mentorë. | |

| | | |
|---|---|---|
| Fushë kurrikulare | Një kategori e gjerë mësimore që grupon lëndët që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për mësimin e dijës, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve. Bashkimi i lëndëve në një fushë të caktuar  mësimore merr parasysh kontributin e tyre specifik në zhvillimin e nxënësve, në pajtim me qëllimet e përgjithshme e të veçanta të procesit mësimor në shkolla. Ai poashtu merr parasysh mundësinë për qasjet multi dhe ndërdiciplinare e gjithashtu edhe realizimin e qëllimeve ndërkurrikulare. | Fushë kurrikulare |
| Inteligjencat e shumfishta | Teori bashkëkohore me ndikim që ka të bëjë me inteligjencën dhe personalitetin (H. Gardner) që thekson se inteligjenca të veçanta mund të detektohen në tru, në vend të një inteligjence të përgjithshme apo të gjenerike, zakonisht të përkufizuara si aftësi për të zgjidhur probleme në mënyrë efektive. Ajo kishte pasoja të rëndësishme në zhvillimin dhe zbatimin e Kurrikulës, posaçërisht përmes konceptit të qasjes me fëmijën apo nxënësin në qendër dhe modelit të zhvillimit të “tërë personit” në procesin e mësimit dhe zhvillimit.<br>Deri me sot janë identifikuar tetë inteligjenca të shumëfishta: gjuhësore; matematike logjike; hapësinore; kinestetike trupore; muzikore;  ndërpersonale; intrapersonale; natyrore. Në mesin e këtyre tetë inteligjencave si shtesë përmendet edhe inteligjenca ekzistenciale/shpirtërore/morale. | |
| Integrimi i Kurrikulës | Procesi i kombinimit/artikulimit të përmbajtjes mësimore dhe lëndore me qëllim të promovimit të mësimit holistik dhe gjithëpërfshirës. Kjo shpie në reduktimin e një numri të lëndëve diskrete dhe zakonisht zbatohet në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. | |
| Klasë bashkëvepruese | Mjedisi mësimor në nivel klase që bazohet në shkëmbime të vazhdueshme mes mësimdhënësve dhe nxënësve në kontekstin e aktiviteteve të bazuara në kërkim, zgjidhje të problemeve dhe punë konkrete. | |

| | | |
|---|---|---|
| Kompetencë | Aftësi të gjera për t'i zbatuar njohuritë,shkathtësitë, qëndrimet, rutinat, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse. | Kompetenca/ Shkathtësitë (nganjëherë kompetencat barazohen me "shkathtësitë", veçanërisht në shprehjet si "shkathtësitë për jetë". Megjithëkëtë, sipas një përkufizimi më të përshtatshëm të kompetencave, shkathtësitë konsiderohen si pjesë përbërëse e tyre së bashku me njohuritë, vlerat dhe qëndrimet (kompetencat gjithashtu përfshijnë rutinat, modelet e të menduarit, sjelljet). |
| Kompetencat kryesore | Kompetenca që konsiderohen nga sistemi i arsimit dhe aftësimit si të rëndësishme për të nxënit e secilit nxënës dhe të kontribuuesve të rëndësishëm në jetën e secilit anëtar të shoqërisë. Kompetencat kryesore që janë më të përafërta me "Arsimin themelor" mund të njihen edhe si "kompetenca themelore". | Kompetencat gjenerike, transversale apo gjithëpërfshirës |
| Koncepti shumë-shtresor iidentitetit | Të kuptuarit e identitetit si rezultat kompleks edhe i faktorëve të para-caktuar edhe i faktorëve zhvillues për shkak të ekspozimit dhe pjesëmarrjes së individëve dhe grupeve të kulturave të ndryshme në kontekstin e fenomeneve aktual të globalizimit. | |
| Korniza e Kurrikulës | Një numër politikash, rregullooresh, orientimesh dhe udhëzimesh që janë qenësore për zhvillimin dhe zbatimin e Kurrikulës që orienton zhvillimin e programeve mësimore dhe dokumenteve të tjera kurrikulare. Duke pasur parasysh statusin e Kurrikulës si një bosht të sistemit arsimor, kornizat e Kurrikulës zakonisht shihen si "kushtetuta" të arsimit parauniversitar. Kornizat e Kurrikulës mund të përpilohen për tërë sistemin, për faza të veçanta (si arsimi themelor) dhe/ose për fusha dhe çështje të veçanta të kurrikulit (si psh. korniza për integrimin e çështjeve të ndërlidhura në Kurrikulë). | |

| | | |
|---|---|---|
| Kurrikula | Tërësia e fushave mësimore, lëndëve dhe çështjeve ndërkurrikulare që gjenden në një sistem arsimor. Koncepti zakonisht përdoret për të nënkuptuar Kurrikulën "formal" apo "të paraparë (të shkruar), por mund të përfshijë edhe Kurrikulën e "paparaparë" apo të "fshehur". Po ashtu, bëhen dallime midis Kurrikulës të "paraparë" (zyrtar), "të zbatuar", "ndërveprues" (që vjen si rezultat i ndërveprimeve në klasë) dhe "Kurrikulës efektiv" (atë se ç'mësojnë në të vërtetë nxënësit). | Kurrikulat (sh.) |
| Kurrikula bërthamë | Kërkesat e përbashkëta për të gjithë nxënësit në aspektin e kompetencave kryesore, lëndët e përbashkëta dhe orientimet e përgjithshme. | |
| Kurrikula efektive | Ajo që nxënësit në të vërtetë e mësojnë në aspektin e dijes, qëndrimeve dhe shkathtësive. | Kurrikula e realizuar |
| Kurrikula e fshehur | Besimet, qëndrimet dhe shkathtësitë që nxënësit i kanë apo i zhvillojnë perms përvojave të tyre personale. Kurrikula e fshehur mund të jetë ose të mos jetë në pajtueshmëri me Kurrikulën zyrtare/të obligueshëm. | |
| Kurrikula formale | Mundësitë dhe përvojat mësimore që iu ofrohen nxënësve në kontekstin e arsimit formal. Kurrikula formale shërben si bazë për certifikata dhe dhënien e diplomave të pranueshme nga shoqëria. | Kurrikula e paraparë/zyrtare/e obliguar |
| Kurrikula me bazë shkolle (ose me bazë në institucion) | Pjesa e Kurrikulës që vendoset në nivelshkolle (ose institucioni). | |
| Kurrikula spirale | Modeli i zhvillimit të Kurrikulës që përfshin përsëritjen periodikisht të dijës, shkathtësive dhe qëndrimeve të ndërlidhura me fusha kurrikulare/lëndë në kontekstin e përvojave mësimore të reja më të gjera e më komplekse. I shërben konsolidimit të mësimit paraprak dhe trajtimit më të thellë të përmbatjes mësimore të re. | Rritja spirale e Kurrikulës/ mësimit |
| Kurrikula zgjedhor | Pjesa zgjedhore e Kurrikulës që përfaqëson lëndet dhe aktivitetet kurrikulare të vendosura në nivelin e shkollës. | Kurrikula me bazë shkolle |
| Lënda | Disiplinë e veçantë mësimore (të tilla si matematika ose historia). | |

| | | |
|---|---|---|
| Lëndë bartëse | Një lëndë që duke u bazuar në fushëveprimin dhe strukturën e saj është më afër të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të caktuara të mësimit dhe mundëson zhvillimin e kompetencave të caktuara tek nxënësit (p.sh. arsimi për punë ose teknologji; zhvillim personal, aftësitë për jetë, studime sociale). | |
| Llogaridhënia | Koncepti i qeverisjes etike (duke përfshirë qeverisjen etike të shkollës) që bazohet në njohjen dhe marrjen e përgjegjësisë për vendimet, veprimet dhe pasojat e tyre dhe ndërlidhet me pritjet për dhënien e llogarisë para palëve me interes. | |
| Metodologjia e vlerësimit | Strategjitë dhe aktivitetet e zbatuara, zakonisht nga mësimdhënësit (në vlerësimin e brendshëm) apo nga agjenci të specializuara (në vlerësimin e jashtëm), për të matur arritshmërinë ose performancën e nxënësit. | |
| Mësimdhënia | Aktivitet që realizohet me qëllim të nxitjes së mësimit tek nxënësit duke përdorur një game të gjerë metodash që iu përshtaten stileve tëmësimit të nxënësve. | |
| Mësimdhënia dhe mësimnxënia bashkëvepruese | Filozofia dhe praktika e përfshirjes së nxënësve për ta përcaktuar dhe ndërtuar përvojën e tyre mësimore duke marrë parasysh nevojat e tyre, interesat, dijen paraprake dhe kontekstin. | |
| Mësimdhënia e diferencuar | Mësimdhënia e diferencuar nënkupton krijimin e programeve të shumëfishta ashtu që nxënësit me aftësi, interesa apo nevoja të ndryshme mësimore të përjetojnë në mënyrë të barabartë rrugët e duhura për të absorbuar, përdorur, zhvilluar dhe prezantuar konceptet si pjesë e procesit mësimor të përditshëm. Iu mundëson nxënësve të marrin përgjegjësi më të madhe dhe pronësi mbi mësimin e tyre dhe ofron mundësi për mësimdhënien përmesshokut dhe nxënien në bashkëpunim. | |
| Mësimdhënia e integruar dhe të mësuarit | Mësimi që reflekton dhe vë në pah lidhjet dhe ndërlidhjet në jetën individuale dhe shoqërore (aktivitetet njerëzore), natyrë dhe dije. | Mësimi holistik dhe i gjithanshëm |

| | | |
|---|---|---|
| Mësimdhënia në bllok | Mënyrë fleksibile për caktimin e orëve të mësimit  duke përcaktuar periudha më kompakte të kohës për lëndët/njësive (për shembull, mësimdhënia e një lënde gjatë një semestri prej gjashtë javësh në vend të orëve javore të shpërndara gjatë tërë vitit shkollor). Kjo mund të zbatohet kryesisht në rast të ndonjë lënde  ku nuk kerkohen sekuenca jashtëzakonisht të rrepta. | |
| Mësimdhënia e zgjeruar dhe koha për të mësuar | Ndarja e një kohe më të madhe për mësimdhënie dhe mësimnxënie të fituar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të caktuara me qëllim që të nxitet mësim i thellë dhe i qëndrueshëm. | |
| Mësimdhënia shoku-shokun | Praktika në të cilën nxënësit marrin rolin e mësimdhënësit në një mjedis shkollor me qëllim të ndarjes së dijës dhe shkathtësive të tyre me nxënësit tjerë. | |
| Mësimi domëthënës | Për dallim nga mësimi përmendësh, shpie drejt zhvillimit të rrjetave konceptuale (d.m.th. hartave konceptuale) që mund të aplikohen në situata të ndryshme dhe që mundësojnë kreativitetin dhe zgjidhjen e problemeve. Në lidhje me pikëpamjet konstruktiviste, poashtu i referohet mësimit që ka kuptim për nxënësit (d.m.th. është i ndërlidhur me përvojat e tyre personale dhe është i orientuar në praktikë dhe punë konkrete). | |
| Mësimi elektronik | Mësimi që bazohet në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit me qëllim të avancimit të qasjes në informata, e po ashtu edhe përdorimi efektiv dhe i përgjegjshëm i tyre në kontekstin (e zakonshëm) të aktiviteteve në distancë dhe rrjet. | |
| Mësimi holistic dhe i gjithanshëm | Mësimi që integron aspektet akademike me zhvillimin e nxënësve duke u përpjekur të trajtojë fenomenet si tërësi duke theksuar ndërlidhjen e dimensioneve dhe proceseve natyrore, shoqërore dhe personale. | Shiko po ashtu “Mësimin e integruar” |
| Mësimi i bazuar në shërbim | Mësim që ndodh si rezultat i angazhimit të nxënësit në ofrimin e ndonjë shërbimi të organizuar, zakonisht në bashkësi lokale apo më gjerë. | Mësim i bazuar në shërbime për bashkësinë |
| Mësimi i qëndrueshëm | Mësimi i ndërlidhur me dhe në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë, ekonomisë dhe mjedisit. | |
| Mësimi tërëjetësor | Paisja e nxënësve me kompetencat e nevojshme për të qenë nxënës të suksesshëm gjatë tërë jetës. | |

| | | |
|---|---|---|
| Mësimnxënia | Procesi i fitimit, absorbimit dhe zhvillimit të dijeve, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të reja janë të integruar në strukturat para-ekzistuese, ndërsa gjithashtu përbëjnë një bazë për përvetësime të reja. | |
| Mjedis miqësor për fëmijët | Ambiente të të mësuarit të cilat janë miqësore, të bazuara në të drejta, gjithëpërfshirëse, e shëndetëshëm dhe mbrojtëse për të gjithë fëmijët. Ato poashtu përfshijnë marrëdhënie të fuqishme mes familjeve/komunitetit dhe shkollës. | Shiko konceptin e UNICEF-it për shkollat dhe sistemet arsimore mike për fëmijët dhe të bazuara në të drejta. |
| Mjedisi për mësimin holistik | Organizimi i përcaktimit të mësuarit që fton nxënësit që të bëjnë përdorimin e njëkohshëm intelektual, emocional dhe aftësitë motorike të tyre. | |
| Mundësitë mësimore | Situata dhe procese që kanë potencial për nxitjen e të mësuarit tek nxënësit . | |
| Nxënës-përqëndrimi | Filozofia dhe praktika e organzimit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit nga perspektiva e nevojave, interesave dhe aftësive të nxënësve. | |
| Periudha kontaktuese | Koha që caktohet zakonisht për bashkëveprimin sistematik mes mësimdhënësve dhe nxënësve në kuadër të një lënde, njësie mësimore dhe/ose mësimi. | |
| Përmbajtja mësimore | Temat, besimet, sjelljet, konceptet dhe faktet, shpesh të grupuara brenda një lënde ose fushë kurrikulare nën dijet, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që priten të formojnë bazën e mësimdhënies dhe të nxënit | Përmbatja |
| Përvoja mësimore | Situatat dhë proceset përmes të cilave nxënësit i fitojnë/zhvillojnë dijet, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet. | |
| Politikat e Kurrikulës | Vendimet formale të bëra nga qeveria ose autoritetet e arsimit që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të rëndësishëm në zhvillimin e kurrikulit. Këto vendime zakonisht dokumentohen në dokumentet zyrtare të qeverisë. | |
| Programi mësimor | Dokument që përshkruan objektivat mësimore, rezultatet dhe përmbajtjen mësimore lidhur me një lëndë të veçantë. Programet mësimore moderne ofrojnë edhe udhëzime për zbatimin e tyre, duke përfshirë metodologji përkatëse për mësimdhënie dhe vlerësim. | Programi i mësimit në/ për një lëndë të caktuar |

| | | |
|---|---|---|
| Progresioni i mësimit të qëndrueshëm | Mësimi që bazohet në integrimin efektiv të mësimeve të mëparshme në sistemet e reja të dijes, shkathtësive dhe qëndrimeve. | |
| Qasjet konstruktiviste | Filozofia dhe praktikat që frymëzohen prej teorive të ndryshme konstruktiviste të mësimit dhe zhvillimit që thekson se të mësuarit ndërtohet përmes kulturës, përvojës individuale dhe shoqërore, si dhe bashkëveprimeve dhe konteksteve.<br>Sipas teorive konstruktiviste, të mësuarit duhet të ketë kuptim (për të qenë kuptimplotë) për nxënësit në mënyrë që të jetë efektiv. | |
| Qëndrimi | Pozicionimi i brendshëm drejt njerëzve, fakteve, fenomeneve, veprimeve, besimeve dhe situatave; gatishmëria e brendshme për të vepruar. | Gatishmëria |
| Rezultatet mësimore | Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dinë nxënësit, të besojnë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë. Rezultatet janë shprehur në Kornizën e Kurrikulës në një varg domenesh, përfshirë dijen, të kuptuarit, shkathtësitë dhe kompetencat, vlerat dhe qëndrimet. | Rezultate<br>Kompetencat e nxënësve<br>Rezultatet e xënësve Arritjet e nxënësve |
| Sistemi i Kurrikulës | Tërësia e dispozitave dhe dokumenteve të Kurrikulës përmes të cilave u jipen udhëzime mësimdhënësve dhe palëve tjera në lidhje me atë së pse, çka, si dhe sa mire duhet të mësojnë nxënësit. Sistemi i Kurrikulës zakonisht përbëhet nga ligjet arsimore, kornizat e Kurrikulës, Kurrikulëet lëndore, standardet e vlerësimit, teksteve shkollore dhe materialeve tjera mësimore. | |
| Standard | 1. Vendim, kërkesë ose rregull që pritet të zbatohet apo aplikohet (për shembull, “standardet e cilësisë/ Kurrikulës”). Standardet e Kurrikulës (cilësisë) mund t’i referohen përmbajtjes mësimore (standardet e përmbajtjes), proceseve (standardet e proceseve), rezultateve (standardet e rezultateve), dhe mjediseve (standardet e mjedisit).<br>2. Niveli i arritjes apo suksesit që pritet të arrihet prej nxënësve nëse duhet t’u jepet ndonjë rezultat i caktuar. | |
| Struktura e Kurrikulës | Mënyra se si është organizuar Kurrikula në cilindo sistem, përfshirë lëndët dhe fushat e kurrikulës, kur ato duhet të mësohen dhe ‘modelin’ me të cilin ato duhet të mësohen. Kurrikula mund të përbëhet, për shembull, prej lëndëve kryesore dhe zgjedhore që mësohen me disa ndryshime midis klasëve të ndryshme | |

| | | |
|---|---|---|
| Shkalla kryesore e Kurrikulës | Faza të caktuara përmes të cilave realizohet Kurrikula përmes niveleve dhe klasave të ndryshme të arsimit. Periudha që mbulojnë karakteristike të përbashkëta në aspektin e zhvillimit të fëmijëve, kërkesave të Kurrikulës dhe qasjeve të mësimdhënies e mësimnxënies për zhvillimin e nxënësve dhe përparimit në nxënie. Në Kornizën e Kurrikulës të Kosovës, shkallët kyçe janë fazat e caktuara në nivelet e arsimit për të siguruar.<br>• më shumë transparencë dhe saktësi në artikulimin e qëllimeve arsimore dhe detyrave;<br>• mundësi për udhëzime konkrete për organizimin e punës së shkollës me theks në metodat specifike, rezultatet mësimore dhe mjetet e vlerësimit;<br>• mundësi për të ofruar sfida të reja sa i përket zhvillimit të nxënësve dhe qëllimeve specifike të secilës shkallë kyçe të Kurrikulës | |
| Shkathtësia | Aftësia për ta zbatuar dijen për të kryer një detyrë të veçantë sipas një standardi të qëndrueshëm (dimensioni operacional/ procedural i dijes). | |
| Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) | Instrumentet dhe proceset e reja për të pasar qasje në informata dhe për t'i përpunuar ato, e po ashtu edhe për t'i komunikuar duke u bazuar në pajisje elektronike si kompjuterë, TV, internet, apo pajisje tjera digjitale. | |
| Vetë-vlerësimi | Vetë-vlerësimi nga nxënësit i arritjeve dhe problemeve të tyre në mësim. Sikur në rastin e vlerësimit shoku-shokun bazohet në shkathtësite intelektuale të nivelit të lartë që i përdorin nxënësit për të vlerësuar mësimin e tyre në aspektin e proceseve dhe rezultateve. | |
| Vlerat | Ato që njerëzit i çmojnë si parime udhëzuese dhe referenca kryesore për zgjedhjet dhe sjelljet e tyre. | |
| Vlerësimi | Procesi i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjykimeve lidhur me arritshmërinë ose performancën e nxënësve. | |
| Vlerësimi diagnostik | Vlerësim që zakonisht realizohet në fillim të procesit mësimor dhe fokusohet në identifikimin e aftësive dhe dobësive të nxënësve që duhet të merren parasysh për përkrahjen e nxënësve që të tejkalojnë problemet e ndryshme në nxënie. | |

| | | |
|---|---|---|
| Vlerësimi formativ | Vlerësim që parimisht është I bazuar në klasë dhe realizohet nga mësimdhënësi me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të përparojnë në mësim gjatë tërë një periudhe të caktuar kohore. E parasheh mësimin si proces e jo vetëm si rezultat (shiko poashtu Vlerësimin për nxënie, me të cilin është i ndërlidhur). | |
| Vlerësimi i jashtëm | Vlerësim që kryhet nga agjenci jashtë shkollore apo bazohet në procedurat dhe instrumentet e ofruara nga agjenci jashtë shkollore (d.m.th. provimet e jashtme; testet e ofruara nga agjenci të specializuara të vlerësimit). Duhet të bazohet në standardet (kombëtare) të vlerësimit që subjektiviteti në vlerësim të zvogëlohet në maksimum. | |
| Vlerësimi i nxënies | Mbledhja e dëshmive valide, të besueshme dhe krahasueshme për të vlerësuar progresin e nxënësve në nxënie (d.m.th. arritshmërinë e tyre në fusha të ndryshme të kurrikulës /lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave kryesore) për t'i arritur standardet minimale për zotërimin e kompetencave kryesore. | Vlerësimi përfundimtar arsimin e detyrueshëm |
| Vlerësim me bazë klase/Vlerësimi nga mësimdhënësit | Vlerësimi që kryhet rregullisht nga mësimdhënësit në klasë si pjesë të mësimit të tyre dhe strategjive të mësimit. Ofron informacion të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm sa i përket arritshmërisë së nxënësve dhe problemeve në mësim. | |
| Vlerësimi parashikues | Vlerësimi që synon të parashikojë dështimet dhe sukseset potenciale në zhvillimin e nxënësve me qëllim që të sugjerohen programme efektive për përparimin e tyre e poashtu edhe veprime të duhura plotësuese në rast të mangësive (të pritura) në mësim. | |
| Vlerësimi për të nxënë | Synon të përkrahë nxënësit të arrijnë kompetencat kryesore duke iu treguar se ku janë sa i përket rezultateve mësimore të parapara. Bazohet në atë që t'i vetëdijësojë nxënësit dhe t'i bëjë pjesëmarrës në përcaktimin e rezultateve mësimore, kritereve të cilësisë dhe treguesëve personal të suksesit. Nxënësit mësojnë se çka duhet të bëjnë që të arrijnë ato rezultate te vendosura mësimore dhe si të arrihet atje. | Vlerësimi formativ |

| | | |
|---|---|---|
| Vlerësimi selektiv | Vlerësimi i të cilit qëllimi kryesor i të cilit është grupimi dhe/ose përzgjedhja e nxënësve në pajtim me kritere të caktuara të suksesit (p.sh. përgjedhja e nxënësve të talentuar për orët e shkencës ose arteve; përzgjedhja e nxënësve që do të pranohen në shkolla të ndryshme të arsimit të mesëm të lartë. | |
| Vlerësimi sumativ | Vlerësimi që përmbledh përparimin dhe arritshmërinë e rezultateve mësimore nga nxënësit në një kohë të caktuar. | |
| Vlerësimi shoku-shokun | Vlerësimi i nxënësve për punën e nxënësve të tjerë (mund të jetë edhe formativ edhe sumativ). | |
| Zhvillimi holistik | Progresi/zhvillimi i harmonizuar i të gjitha dimensioneve d.m.th. aspekteve intelektuale, emocionale dhe motorike. | Qasje për zhvillimin e “personit të plotë” |

# Bibliografia


Acedo, C., Ferrer, F. & Pamies, J. (2009). Inclusive education: Open debates and the road ahead. In *Prospects 151,* Vol. XXXIX, no. 3. pp. 227-238.

Amstrong, Th. (1994). *Multiple Intelligences in the Classroom.* Alexandria: Virginia: Association for Supervision and Curriculum Development (ASCD).

Australia. Department of Education, Science and Training & Australian National Training Authority. (2002). *Employability Skills for the Future.*

Australia. Queensland Government. Department of Education, Training and The Arts. (2008). P12 *Curriculum Frameëork. Incorporating Policies, Principles and Guidelines for Queensland State Schools.*

Botany, R., Magnin, Ch. & Zottos, e. (Eds.) (2005). L'enseignement *secondaire* a l'ŕchelle *mondiale: bilans et perspectives.* Actes *du colloque de* Genëve *5-7* septembre 2004./ Secondary *Education worldwide: Assessment and Perspectives. Proceedings of the Geneva Meeting 5-7 September 2004.* Geneva : DIP, SRED, UNESCO IBE & UNIGE/ FAPSE. Brady, L. & Kennedy, K. (1999). *Curriculum construction.* Prentice Hill.

Conjard, P. & Devin, B. (Eds.). (2007). *La professionalisation:* acquŕrir *et transmettre des* compŕtences. Lyon: Anact.

Braslavsky, C. (Ed.). (2006). *Textbooks and Quality Learning* for All: *Some Lessons Learned from International Experiences.* Geneva: UNESCO International Bureau of Education.

Braskavsky, C. & Benavot, A. (Eds.). (2006). *School Knoëledge in Comparative and Historical Perspective. Changing Curricula in Primary and* Secondary *Education.* Comparative Education Research Centre, The University of Hong Kong & Springer.

Crisan, A. (2006). *Current and Future Challenges in Curriculum Development: Policies, Practices and Netëorking for Change.* Bucharest: Editura Educatia 2000+ Humanitas Educational.

Colëill, I. & Galagher, C. (2007). Developing a curriculum for the twenty-first century: the experiences of England and Northern Ireland. In *Prospects 144,* vol. XXXVIII, no. 4 (Open file: Curriculum Developers facing Education Reform Challenges). pp. 411-426.

Council of Europe. (2004). *All European Study on EDC Policies.* Education for Democratic Citizenship Activities 2001-1004. Strasbourg.

Dale, R. & Robertson, S. (Eds.). (2009). *Globalisation and Europeanisation in Education.* Symposium books.

Delors, J., Al Mufti, I. & Amagi, I. (Eds.). (1996). *Learning. The Treasure Within: Report to UNESCO of the International Commission on Education for the Twenty-first Century.* Paris:UNESCO.

Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës. *(2001). Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës (arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë), libri i bardhë për diskutim.* Prishtinë

Instituti Pedagogjik i Kosovës *(2010). Kërkime Pedagogjike (përmbledhje punimesh),* Prishtinë.

Piaget, J. *(2005). Mbi Pedagogjinë.*Tiranë: Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve

Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve. *(2006). Revista Pedagogjike.* Tiranë

Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve. *(2005). Edukimi Parashkollor.* Tiranë

Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve. *(2005). Kurrikula dhe Shkolla.* Tiranë

Earl. L., Watson, N. & Katz, S. (2003). *Large-Scale Education Reform: Life Cycles and Implications for Sustainability.* The Centre for British Teachers CfBT.

England Department for Education and Employment (DfEE) and Qualifications and Curriculum Authority (QCA). (1999). *The national curriculum, handbook for teachers (pp.* 10-13). London: **HMSO.**

England. QCA. (2000). *The revised national curriculum.* London. See www.qca.org.uk/qca_13575.aspx or www.nc.uk.net.

England. Department for Education and Skills (DfES). (2000). *Schemes of work.* London. See www.standards.dfes.gov.uk/schemes3/.

England. QCA. (2004). *The futures website.* London. See www.qca.org.uk/qca_6073.aspx.

England. QCA. (2007a). *The neë secondary curriculum.* London. See www.currriculum.qca.org.uk/aims/index.aspx.

England, QCA. (2007b). *A big picture of curriculum.* London. See http:/7curriculum.qca.org.uk/key-stages-3-and-4/organizing-yourcurriculum/principles_of_curriculum_design/bigpicture.aspx.

Ettayebi, M., Jonnaert, Ph., Opertti, R., (Eds.) (2009). *Logique de compŕtences et dŕveloppement curriculaire: debats, perspectives et alternative.* Editions L'Harmattan.

European Commisssion. Directorate-General for Education and Culture. (2000).

*European Report on the Quality of School Education. Sixteen Quality Indicators.* Report based on the work of the working Committee on Quality Indicators.

Farstad, H. (2004). *Competencies for Life: Some Implications for Education.* Background Paper to workshop 3: Quality Education and Competencies for Life. UNESCO 47$^{th}$ Session of the International Conference on Education.

Flinders, D. J. & Thornton, S. J. (Eds.). (2004). *The Curriculum Studies Reader.* (2$^{nd}$ edition). New York: Routledge.

Fakulteti i Edukimit. *(2010). Hulumtimet në shkencat e edukimit nr.1 Vol 7.* Prishtinë

Gardner, H. (1993). *Multiple Intelligences. The Theory into Practice.* A Reader. Basic Books.

Georgescu, D. (2002). On curriculum development in Kosovo. In *The Development Education Journal.* Vol. 9.1. pp. 29-20.

Georgescu, D. & Palade, E.(2003). *Reshaping Education for an Open Society in Romania 19902000: Case Studies in Large-Scale Education Reform.* Vol. II, no 3. The world Bank.

Georgescu, D. (2005). Le role de l'education dans les situations de post-conflit. Les experiences du Bureau International d'Education (BIE). In Aligisakis, M. (Ed.). (2005). *L'Europe et la sorite des conflits.* Geneve: EURYOPA Institut Europen, Universitë de Geneve.

Georgescu, d. (2006). Curriculum Philosophies for the 21st Century: what is old and what is new?

In Crisan, A. (2006). *Current and Future Challenges in Curriculum Development: Policies, Practices and Networking for Change.* pp. 79-96. Bucharest: Editura Educatia 2000+ Humanitas Educational.

Georgescu, D. (2007). Introduction to the Open File. In *Prospects 144,* vol. XXXVIII, no. 4. (Open file: Curriculum Developers facing Education Reform Challenges).

GTZ & BMZ. (2008). *Learning to Live Together. Design, monitoring and evaluation of education for life skills, citizenship, peace and human* rights.(in collaboration ëith UNESCO IBE).

Harland, J. et al. (2002). *Is the curriculum working?* London: NFER.

Keating-Chetwynd, S. (Ed.), Brett, P., Mompoint-Gaillard, P. & Salema, M. H., (2009). *How all teachers can support citizenship and human rights education: a framework for the development of competences.* Strasbourg: Council of Europe Publishing.

MASHT *(2003). Plani dhe Programi Mësimor 1.* Prishtinë

MASHT *(2004). Plani dhe Programi Mësimor 2.* Prishtinë

MASHT *(2005). Plani dhe Programi Mësimor 3.* Prishtinë

MASHT *(2005). Plani dhe Programi Mësimor 4.* Prishtinë

MASHT *(2005). Plani dhe Programi Mësimor 5.* Prishtinë

MASHT *(2003). Plani dhe Programi Mësimor 6.* Prishtinë

MASHT *(2004). Plani dhe Programi Mësimor 7.* Prishtinë

MASHT *(2005). Plani dhe Programi Mësimor 8.* Prishtinë

MASHT *(2002). Plani dhe Programi Mësimor 9.* Prishtinë

MASHT *(2005). Plani dhe Programi Mësimor 9.* Prishtinë

MASHT *(2003). Plani dhe Programi Mësimor 10.* Prishtinë

MASHT *(2004). Plani dhe Programi Mësimor 11.* Prishtinë

MASHT (2005). Plani dhe Programi Mësimor 12. Prishtinë

MASHT *(2005). Plani dhe Programi Mësimor 13.* Prishtinë

McCormick, R. & Murphy, P. (2000). Curriculum. The case for a focus on learning. In Moon, B., Ben-Peretz, M. & Brown, S. (Eds.). (2000). *Routledge International Companion to Education.* London: Routledge. pp. 204-234.

New Zealand. Ministry of Education. ( Year not mentioned ). *The New Zealand Curriculum Framework.* wellington. See http://www.tki.org.nz/r/governance/nzcf/index_e.php

Northern Ireland. (1999). *Key messages from the Curriculum 21 conferences and the curriculum monitoring programme.* Belfast.

Northern Ireland. CCEA. (2007). *The new Northern Ireland curriculum website.* See www.nicurriculum.org.uk. For Thematic Units, see www.nicurriculum.orguk/connected_learning/thematic_untis/.

Norway. The Royal Ministry of Education, Research and Church Affairs. (1999). *The Curriculum for the 10-Year Compulsory School in Norway.* Norwegian Board of Education. (See http://www.ls.no).

Norway. The Royal Ministry of Education, Research and Church Affairs. (Year not mentioned).

*Core Curriculum for Primary, Secondary and Adult Education in Norway.* Norwegian Board of Education. (See http://www.ls.no).

OECD. (2008). *Trends Shaping Education.* Centre for Educational Research and Innovation.

OECD. *(2009). Education today: The OECD Perspective.* Centre for Educational Research and Innovation, Education & Skills.

OSCE, ODIHR, Council of Europe, OHCHR & UNESCO. *(2009). Human Rights Education in the School System of Europe, Central Asia and North America: A Compendium of Good Practice.* (edited by Tibbitts, F.)

Perry, L. B. & Tor, G. *(2008).* Understanding educational transfer: theoretical perspectives and conceptual frameworks. In *Prospects 148, Vol.* XXXVIII, no. *4. pp. 509-526.*

Pinar, w. F. (Ed.). *(2003). International Handbook of Curriculum Research.* Routledge.

Ross, A. *(1999). Curriculum. Construction and Critique.* London & New York: Falmer Press.

Rychen, D. s. & Tiana, A. *(2004). Developing Key Competencies in Education. Some Lessons Learned from International Experience.* Geneva: UNESCO International Bureau of Education.

Savolainen, H. *(2009).* Responding to diversity and striving for excellence: the case of Finland. In *Prospects 151, Vol.* XXXIX, no. *3. pp. 281-292*

Schleicher, A. *(2006). The Economics of Knowledge. Why Education is Key to Europe's Success.* The Lisbon Council Policy Brief.

Schleicher, A. *(2009).* Securing quality and equity in education: Lessons from PISA. In

*Prospects 151, Vol.* XXXIX, no. *3. pp. 251-280.*

Scotland. Scottish Qualification Authority. *(2003). Key competencies – some international comparisons.* Policy and Research Bulletin. Bulletin no. *2.*

Scotland. Smarter Scotland Scottish Government, HMIE – Improving Scottish Education, SQA & Learning Teaching Scotland. *Curriculum for Excellence.* Edinburgh. See www.curriculumforexcellencescotland.gov.uk.

Scotland. Scottish Executive. *(2006). A Curriculum for Excellence. Building the Curriculum 1. The contribution of Curriculum Areas.* Edinburgh.

Scotland. The Scottish Government. *(2008). Curriculum for Excellence. Building the Curriculum 3. A Frameëork for Learning and Teaching.* Edinburgh.

South Africa. *(2005). Revised National Curriculum Statement Grades R-9* (Schools) Policy – Overview and Learning Area Statements. See www.dest.gov.au/sectors/school_education_initiatives_revie.

The world Bank. *(2005). Reshaping the Future. Education and Postconflict Reconstruction.* Washington, D. C.

UNESCO Global Monitoring Report *2005. (2004). The Quality Imperative.* UNESCO Publishing.

UNESCO. *(2005). Towards Knowledge Societies.* Paris: UNESCO Publishing.

UNESCO Global Monitoring Report *2008. (2007).* Education for all by *2015. Will we make it?.* UNESCO Publishing and Oxford University Press.

UNESCO, UNESCO IBE & ISESCO. *(2008). Thinking and Building Peace through Innovative Textbook Design. Report of the Inter-regional Experts' Meeting on Developing Guideliens for Promoting Pace and Intercultural understanding through Curricula, Textbooks and Learning*

*Materials.* Paris: UNESCO. (authors: Georgescu, D. & Bernard, J.).

U. S. Department of Education, Institute of Education Sciences, National Center for Education Evaluation and Regional Assistance. *(2003). Identifying and Implementing Educational Practices Supported by Rigorous Evidence: A User Friendly Guide.*

Zgaga, P. *(2005). The Importance of Education in Social Reconstruction.* Ljubliana & Wien: Centre for Educational Policy Studies & Austria KulturKontakt.

White, G. *(2004). Rethinking the School Curriculum.* Values, Aims and Purposes. London: Routledge Falmer.

William, D. *(2000).* Standards. What are they, what do they do and where do they live? In Moon, B., Ben-Peretz, M. & Brown, S. (Eds.). *(2000). Routledge International Companion to Education.* London: Routledge. *pp. 351-363.*

Whitby, K., Filmer-Sankey, C. & S. O'Donell, *S. (2005). International Review of Curriculum and Assessment Frameworks. Thematic Probe: The Teaching of Skills in Lower Secondary Education.* QCA & National Foundation for Educational Research (NFER). (See also *INCA Education around the world* supported by Qualifications and

Curriculum Development Agency/QCDA and NFER - http://www.inca.org.uk/thematic_probes.html)

Zhvillimi i arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë. *(2008). Sfidat dhe rezultatet (antologji).* Prishtinë: Përkrahja finlandeze për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë

# Në hartimin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës morën pjesë:

**Grupi për Finalizimin e KKK:**
*Nehat Mustafa*, zëvendësministër në MASHT
*Drita Kadriu*, këshilltare politike në kabinetin e Ministrit
*Ragip Gjoshi*, këshilltar politik në kabinetin e Ministrit
*Xhavit Dakaj,* sekretar i përgjithshëm në MASHT
*Halim Hyseni*, ekspert i arsimit
*Ramush Lekaj*, udhëheqës i Divizionit për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar
*Mustafë Kadriu*, udhëheqës i Divizioni të vlerësimit dhe standardeve.

**Ekipi drejtues:**
*Sabri Tahiri,* profesor në UP dhe kryetar i Këshillit Shtetëror për Kurrikulë (KSHKK)
*Nezir Çoçaj,* drejtor i Institutit Pedagogjik ish këshilltar politik në Kabinetin e Ministrit
*Agim Bërdynaj,* drejtor i Departamenti për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar -MASHT
*Alush Istogu,* drejtor i Departamenti për Administrimin e Arsimit Parauniversitar-MASHT
*Ramush Lekaj,* udhëheqës i Divizionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniverstar.

**Grupi teknik**
*Armend Tahirsylaj,* udhëheqës i ekipit teknik (gusht 2009-gusht 2010)
*Flora Kryeziu,* udhëheqëse e ekipit teknik (tetor 2010-qershor 2011)
*Luljeta Belegu Demjaha***,** bashkëpunëtore e jashtme e MASHT për hartimin e Kornizës së Kurikulës në kuadër të ekipit teknik (gusht 2009-qershor 2011)
*Lindita Boshtrakaj***,** bashkëpunëtore e jashtme e MASHT për hartimin e Kornizës së Kurikulës në kuadër të ekipit teknik (gusht 2009-qershor 2011).

**Konsulentët ndërkombëtar:**
Dakmara Georgescu, programme specialist, konsulente (IBE UNESCO) e angazhuar nga UNICEF (july 2009 to february 2010).
Mr Ian Colwill, Consultant (august – september 2009)
Ms Carmel Gallagher, Consultant (august – november 2009)
Ms Felisa Tibbitts, Consultant (november 2009)
*Alexandru Crisan*, konsulent internacional nga Projekti EU Edu SWAp

**UNICEF-i ka përkrahur MASHT-in në procesin e rishikimit, hartimit dhe botimit të KKK**

## Kontribuesit tjerë (të renditur sipas alfabetit):

Abdurrahman Simnica, Divizioni i arsimit profesional
Agim Gashi, profesor në Fakultetin e Shkencave Natyrore
Agim Rexhepi, inspektor i arsimit
Agim Rusinovci, profesor në Akademinë e Arteve, Universiteti i Prishtinës
Agim Vinca, profesor në Fakultetin Filologjik, anëtar i KSHKK
Agni Dika, profesor në Fakultetin Teknik, Universiteti i Prishtinës
Ali Shabani, kryetar i SBASHK-ut
Arber Salihu, Sektori i planprogrameve në MASHT
Argjend Osmani, ekspert i IT
Arif Demolli, Sektori i teksteve mësimore në MASHT
Azem Guri, drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Kaçanik
Bathtiar Kryeziu, profesor në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës
Bajram Beqiri, kryetar i Këshillit të Prindërve
Bajram Berisha, prorektor në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës
Behxhet Mustafa, profesor në Fakultetin SHMN, Universiteti i Prishtinës
Besa Luzha, profesoreshë në *Fakultetin e Muzikës*, (Akademinë e Arteve) Universiteti i Prishtinës
Besa Zagragja, inspektore e arsimit, Prishtinë
Binak Gerguri, hulumtues në Institutin Pedagogjik
David Royle, ekspert kyç i kurrikulave dhe zhvillimit të trajnimit në projektin EU Ed SWAp
Eda Vula, profesor në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës
Edmond Beqiri, profesor, Universiteti i Prishtinës
Emine Bakalli, profesor në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës
Enesa Kadiq, udhëheqëse e Divizionit për Minoritete dhe Gjini në MASHT
Eric Woods, koordinator i Programit Edu SWAp
Feime Llapashtica, Sektori i Planprogrameve në MASHT
Ferit Idrizi, drejtor i Departamentit për Integrime Evropiane në MASHT
Fetah Bylykbashi, pedagog, Sektori i edukimit parashkollor
Fetah Kosumi, Sektori i arsimit të mesëm të ulët
Hajrije Devetaku, hulumtuese në Institutin Pedagogjik
Haki Xhakli, profesor në Fakultetin e Edukimit
Igballe Cakaj, udhëheqëse e Sektorit të Trajnimit në MASHT
Islam Krasniqi, profesor në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës
Ismet Potera, hulumtues në Institutin Pedagogjik
Kismete Hyseni, profesoreshë e letërsisë
Laberi Luzha, udhëheqëse e Sektorit të edukimit parashkollor
Linda Salihu, profesoreshë në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës
Lindita Rugova, profesor në Fakultetin Filologjik, Universiteti i Prishtinës
Lulavere Behluli, udhëheqëse e Sektorit të Arsimit Special
Merita Jonuzi, koordinatore për të drejtat e fëmijëve në MASHT
Milaim Elshani, udhëheqës i Sektorit të inspektimit në Prizren
Minir Efendia, profesor në Fakultetin SHMN, Universiteti i Prishtinës
Mirlinda Zeka, Sektori i vlerësimit dhe standardeve

Naim Syla, profesor në Fakultetin SHMN
Nezir Hajdini, inspektor i arsimit në Sektorin e Inspektimit në Mitrovicë
Nizafete Kutllovci, Sektori i vlerësimit dhe standardeve në MASHT
Nuhi Gashi, koordinator për mësimin plotësues në diasporë
Radica Berishaj, udhëheqëse e Sektorit të arsimit tërëjetësor në MASHT
Ramiz Hoti, profesor në Fakultetin SHMN, Universiteti i Prishtinës
Remzi Salihu, drejtor i Drejtoratit Komunal të Arsimit në Prishtinë
Rexhep Kastrati, Sektori i planprogrameve në MASHT
Ryve Prekoroxha, Divizioni i arsimit profesional në MSHT
Selim Mehmeti, hulumtues në Institutin Pedagogjik
Shejnaze Elezi, Sektori i planprogrameve në MASHT
Shemsi Krasniqi, profesor në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës
Shqipe Gashi, Sektori i Planprogrameve në MASHT
Tom Gougeon, konsulent në EU Edu SWAp
Valbona Rexhepi, profesor në Fakultetin e Edukimit Fizik, Universiteti i Prishtinës
Vedat Kiseri, profesor i Fakultetit të Edukimit, Universiteti i Prishtinës
Vlera Kastrati, konsulente e UNICEF për rishikimin e KKK-se nga aspekti i barazisë gjinore
Zef Osmani, udhëheqës në Sektorin e Inspektimit të Gjakovës.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37.016

Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës / Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. - Prishtinë : MASHT, 2011. - 86 f.

Bibliografia : f. 78-83

**ISBN 978-9951-16-044-5**

ISBN 978-9951-16-044-5